

AROILE SEMINI

8SH-32

54L

RE
DHE
RREZE

NOVELË

891.983-32

541

5

ARQILE SEMINI

RE DHE RREZE

(Novelë)

~~4862~~ 2329

SHËNJA E SHTETIT
SHËNJA E SHTETIT

SHËNJA E BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NË VEND TË HYRJES

Në këtë novelë bëhen përpjekje për të dhënë ndikimin e madh që ushtri në lëvizjen revolucionare të vendeve të ndryshme qëndrimi i vendosur i Partisë së Punës së Shqipërisë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, kundër sulmeve të hapura të revizionistëve modernë dhe, në radhë të parë, të atyre sovjetikë. Ngjarjet janë jetuar nga autori. Ato zhvillohen në një vend kapitalist rreth viteve 1961-62 pas sulmit të hapur që bëri Hrushovi nga tribuna e Kongresit XXII të PK të BS, në tetor të 1961, kundër PPSH.

Militantët komunistë, në kohën që udhëheqja e partisë së tyre po rrëshqiste drejt llumit revizionist, në fjalimin e shokut Enver Hoxha, të mbajtur me rastin e 44-vjetorit të Revolucionit të Tetorit dhe 20 vjetorit të themelimit të PPSH, gjetën të vërtetën marksiste-

-leniniste. Ngjarjet e novelës përshkruajnë luftën, përpjekjet e para të militantëve marksistë-leninistë në këtë vend kapitalist për të mbrojtur kauzën e klasës punëtoare.

Nga autori

NË SPITAL

E dija që do të mbaroja në spital me rrugën që kisha marrë. Nuk munda t'i bëja ballë grushtit që më dha jeta: zhgënjim për fejesën me Pol Tenienin; shqetësim për përçarjen e familjes në dy kampe politike kundërshtare, nga njëra anë babai me motrën, në anën tjetër vëllai. Unë kërkoja rrugën time, dashurinë time të vërtetë. Kjo gjë ishte shumë e vështirë. Kisha parasysh kushtet në të cilat jetoja: shoqërinë borgjeze me ligjet e saja të tmerrshme. Përveç kësaj duhej të zgjidhja në do të mbaja anën e babait apo të vëllait. E kuptoja se me asnjansinë time nuk mund të vazhdoja gjatë. Prandaj thoshja se, duke u shtruar në spital, do të kisha kohë të mendoja për hallet që më kishin zënë derën. Megjithatë, kur kalova para dy muajsh një krizë të lehtë në zemër me origjinë nervore e mjekët më këshilluan të shtrohesh në spital, unë kundërshtova. Spitali më dukej i mërzitshëm si kurg. Kështu thoshin! Në atë kohë nuk njihja as njërin as tjetrin. Kisha frikë vetëm mërzitjen. Kjo mund të më sëmurte më keq. Mirëpo xha Morisi ose Albanezi — siç e thërrisnim

në shtëpi — nguli këmbë që të shtrohesha. Më në fund ndoqa këshillën e tij, u shtrova në spitalin e studentit.

Më vunë në një dhomë me Mari-Terezën. Kjo ishte një vajzë e dashur, por e bezdisshme. Mua më dukej kështu, se e mora për ters që në fillim. Nuk i honepsja dot ca teke e mënyra të saja të një mikroborgjezeje mendjelehtë. Dhe me këtë sy e pashë për aq kohë sa ndenja me të në një dhomë. Megjithatë gjeta mënyrën për të ngushulluar veten, që rashë me një shoqe të tillë: Mari-Tereza u bë shkak që unë të njihesha me Izidor Romelon...

Një ditë u zgjova heret në mëngjez, më herët se zakonisht. Më dhimbte koka. Thashë të hapja dritaren... Jashtë binte dëborë. Vetëm panorama e bardhë nuk më kënaqte. Desha që ajri i ftohtë i dëborës të hynte në dhomë. Kjo do të më qetësonte. Ky mendim m'u ngul në kokë. Mirëpo Mari-Tereza po flinte. Nuk mund ta zgjuaja. S'mund ta hapja dritaren pa lejen e saj. Ajo kurrë s'më kish thënë se duhej t'i merrja leje për këtë gjë. Prapëseprapë prania e saj nuk më lejonte të hapja dritaren. Ahere u nevríkosa më keq...

E shfrevë dufin e inatit me veten...

Zbrita me rrëmbim nga shtrati. Vesha robde-shambrin, mora sendet e tualetit dhe frymën e mbajta në banjë. Të sëmurët akoma s'ishin zgjuar. Heshtja e spitalit i ngjante heshtjes së varrit. Këtë gjë unë e dalloja vetëm ahere kur zgjohesha më herët se të tjerët... Në sallën e banjës isha vetëm. Shkova para pasqyrës, rregullova flokët me dorë dhe po vështroja me imtësi tiparet e fytyrës. Ngela e pakënaqur nga fytyra ime: aty nuk shprehej gjithë forca dhe dufi i ndezur i shpirtit. Shumë keq!.. Me

sy gjysmë të mbyllur, kërkoja diçka në një sfond të përfytyruar (Mari-Terezën të përqaftuar me një djallë), por dëshira e egër nuk ma trubullonte fantazinë e qartë që të më shkëpuste nga realiteti. Këtë gjë e kërkoja me ngulm vetëm e vetëm që të justifikoja dyshimet, që më kishin pushtuar, për marrëdhënjet që kish Mari-Tereza me një të sëmurë të katit të katërt. E pashë që po vrisja mendjen kot me iluzione dhe dëshira të paqarta. . . Hyra në një nga ndarjet me dush. U zhvesha. Zgjata dorën nga rubinetat. Një afsh i vakët më mbuloi nga sipër. Ngrita fytyrën drejt dushit dhe mora një copë herë frymë thellë, shumë thellë, derisa u ngopa. Pastaj u fërkova mirë me sfyngjer, u shplava përsëri me ujë të nxehtë dhe aty për aty e ndjeva veten mirë, të lehtësuar, të kënaqur. Kur dola nga dushi, u fshiva dhe shkova para pasqyrës për të krehur leshrat. Faqet më ishin bërë flakë nga të nxehtit. Më dukej sikur një avull i hollë trëndafil ngrihej nga faqet e mia. Në ato çaste ndjeja vetëm mirësi, ëmbëlsi për jetën, ndjeja vetëm dashuri të pastër. Dhe papritur, si në mjegull, më doli në pasqyrë (që ish veshur me avull) fytyra e një djali. Më rrahu zemra, ktheva kokën. Një djallë i panjohur rrinte prapa meje pa lëvizur, me një peshqir të madh hedhur në sup. Më vështronte me qetësi. Unë s'e kisha ndjerë kur kish hyrë. E shikova disa çaste dhe instinktivisht e kuptova se i panjohuri i heshtur po më tërhiqte.

— Mirë mëngjezi! — i fola unë.

Ai vuri buzën në gaz. M'u përgjegj me sy.

Mua m'u rrënoqeth mishtë. Një ide e çmendur më shkrepri në kokë. «Mos është ky njeriu që kërkoj?! Duket djallë simpatik, me shprehje të veçantë,

me botë të brendshme misterioze?!» Kështu m'u duk me pamjen e parë. I hodha një vështrim të fortë dhe për një çast pandeha se ja vodha zemrën. Pas kësaj desha të largohesha si një sorrë grabitqare. Ai s'më la, më kapi nga krahu.

— Si ju quajnë? — më pyeti.

— Zhaklinë Monor.. Po juve?

— Izidor Romelo — më tha ai dhe më shikoi me sy të ndezur.

— Në ç'dhomë?...

Izidori nuk më la të vazhdoja:

— Ikni tani, do të kemi rast të njihemi më mirë!

Unë e përshëndeta dhe u largova kokulur.

U ngjita në dhomë pa u nxituar. Hyra brenda. Mari-Tereza flinte akoma. Shumë mirë që ajo flinte!.. Zemra më gufonte nga një gaz dehës, që s'e kisha provuar asnjëherë më parë. E ndjeva veten të lumtur (të paktën për disa çaste). E pata mendjen në vend e thashë me vete: «Ja se ç'na qënka lumtëria: një gaz dehës, i paqartë, një kënaqësi që buron nga ndjenja kontradiktore... Për rastin tim kështu është, për të tjerët nuk e di!».. Ç'është e vërteta, në ato çaste pata frikë nga gazi i lumtërisë. Një forcë e panjohur më shtynte drejt dritares të fluturoja; kërkoja hapësirë. Shkurt: pata frikë se mos bëja ndonjë marrëzi. Prandaj shkova përsëri në shtrat, u shtriva dhe mbulova kokën me batanie.

Pasi u qetësova pak, i dhashë karar punës që t'i shikoja ngjarjet me gjakftohtësi. Kështu mund të isha më e arësyeshme... Duhej t'i shikoja gjërat me imtësi. Ishte fjala për momentet kryesore të jetës sime, sidomos të viteve të fundit.....

Babai im kish qënë punëtor. E vranë gjermanët

gjatë luftës së dytë botërore. Nëna vdiq nga zemra pesë vjet më vonë. Ahere lufta kish mbaruar. Babai nuk më kujtohet fare. Kur isha e mitur më thoshin se ai kish dhënë jetën për atdheun; e quanin patriot. Këtë gjë unë s'e kuptoja, por ngushëllohesha. Thoshja se babai im kish qenë njeri i mirë, ngaqë për të flisnin me respekt. Mua aq më duhej. Tmerret e luftës i lidhja gjithmonë me vrasjen e tim atit. Tani babai më kujtohet vetëm në ato raste kur bëhet fjalë për luftën... kurse nënën e kam të gjallë para syve. Ajo ishte e mirë dhe e dashur me mua. Albanezi më thotë shpeshherë se unë i ngjaj shumë asaj nga pamja dhe karakteri. Vetëm kaq më la nëna, asgjë tjetër, asnjë mbështetje.

Të ngelësh jetime qysh në moshën e mitur, është një fatkeqësi e madhe. Kështu thonë. Kështu mund të jetë për të tjerët. Për mua jo. Mbase unë pata fat që më mori në shtëpi dhe më rriti Moris Perieja. Prandaj s'e ndjeva veten jetime. Sidoqoftë jetimet do të jetojnë, do të rriten. Dhe me kohë sikur e harrojnë të kaluarën. Bashkë me të dhe prindërit. Për ta ngel një kujtim plot mall, që në moshën e rritur kthehet në respekt për njerëzit që u dhanë jetën. Vetëm kaq bënë ata, prindërit. Por kjo nuk mjafton. Është më vështirë të jetosh se sa të dalësh në jetë. Nën këtë prizëm, kujdestari bëhet njeriu më i dashur, më i nevojshëm. Prandaj ndjen detyrime të mëdha karshi tij.

Moris Perieja dhe babai kishin qenë shokë të ngushtë. Miqësia e tyre ishte e vjetër, e çuditshme, miqësi punëtorësh. Një miqësi e tillë mund të lindë vetëm mbi bazat e interesave të klasës punëtore. Dikur unë s'e kuptoja këtë gjë, por e pranoja, e respektoja. Për hir të kësaj miqësie unë gjeta strehë në

shtëpinë e xha Morisit dhe u rrita, mbase, më mirë se sa do të isha rritur te prindërit e mi.

Unë isha fëmija e tretë në familjen e xha Morisit. Fëmija e madhe ishte djalë, Zherari; e vogla vajzë, Luiza. Që të dy më të mëdhenj se unë nga mosha. Xha Morisi ishte martuar me një gjermane, që banonte prej kohe në vendin tonë. Historinë e martesës së tyre s'e mësova dot, ajo ngeli mister për mua dhe për Zherarin me Luizën. Xha Morisi shkante shumë keq me të shoqen. Megjithatë ata jetonin bashkë. Edhe këtë gjë s'arrija ta merrja vesh. Nganjëherë thoshja se faji ishte i nënës së Zherarit. Xha Morisit s'i hidhja kurrë faj, se atë e doja. Por në këtë ngatërresë kishte diçka të panjohur për mua, që më bënte të rrija asnjësesë. Gruaja ishte lidhur me të birin, xha Morisi me të bijën. Që të dy kishin nga një ndjenjë dobësie karshi fëmijëve të tyre, të cilët kishin marrë anë të kundërta. Xha Morisi ishte zemërgjërë, e shoqja ishte e pamëshirshme, prandaj e tregonte haptazi dashurinë e saj për të birin dhe ftohtësinë ndaj së bijës. Karshi meje nëna e Zherarit ishte e sjellshme, por jo e ngrohtë. Me edukimin tim u muar vetë xha Morisi. Ai linte kokën për mua. Kjo gjë më ngrohte zemrën, më rritte çdo ditë. Por dashuria e tij më trembte nganjëherë. Pandeja se shkaku i grindjes së xha Morisit me të shoqen isha unë... Grindja në familje mori fund me vdekjen e nënës së Zherarit para gjashtë vjetve. Ne jetuam një periudhë të gjatë në qetësi, në harmoni të plotë. Grindja e dytë plasi para pak kohe midis xha Morisit dhe të birit...

Kështu u rrita: pa andrallë dhe me sedër të përkëdhelur.. Në moshë fare të re u ndodha përballë një prove të jetës. Që në vitet e para të liceut rashë

në dashuri me një djalosh vërsnik me mua, me të cilin nuk përfundova (histori të këtilla ndodhin shpesh në shoqërinë tonë). Dashuria jonë ishte një lojë e këndshme, zbavitëse, serioze në dukje, por jo e qartë. Në atë kohë jeta më dukej e bukur, e lehtë. Prandaj dhe dashurinë e vlerësoja me atë sy. Në fund të fundit e gjithë jeta ime përmbli dhej në dashurinë. Për dashurinë nuk kisha ndonjë koncept të qartë, nuk njihja moralin dhe pasojat e saj...

Fejesën me Pol Tenienin e pranova si një provë të dytë në jetë. Ajo ishte e lidhur me ngjarjet e fundit në familjen e Moris Periésë. Shkaqet ishin të jashtme, politike. Xha Morisi dhe Zherari u ndanë përfundimisht në dy kampe kundërshtare pas tetorit të 1961-së, kur Hrushovi sulmoi hapur Shqipërinë: i pari me shqiptarët, i dyti me rusët. Ndofta këto kontradikta ndizeshin më shumë dhe nga ftohtësia e vjetër që kishin njëri karshi tjetrit atë e bir. Zherari e thërriste me përbuzje të atin «Albanez». Kështu filluam ta thërrisim të gjithë, por pa paramendime. Xha Morisit iu mësua veshi me këtë emër dhe me kohë sikur i pëlqente ta thërrisim «Albanezi». Zherari ishte sekretar Federate i Partisë Komuniste. Me një fjalë, funksionar. Albanezi ishte komunist i vjetër, veteran. Pol Tenieni ishte sekretar privat i Zherarit. Deri në vrasjen e Izidor Romelos, unë nuk munda ta përcaktoja se ç'tip ishte i fejuari im. Ai rridhte nga një familje e pasur borgjeze, të cilën e kish braktisur për «revolucionin»!. Albanezi nuk ishte dakord me fejesën tonë. Ai thoshte për Polin se ishte një tip aventurieri.

«Dëgjo, Zhakline, — më thoshte Albanezi, — Bijtë e borgjezisë, që kalojnë në radhët e partisë komuniste, unë i njoh mirë, kam pasur disa raste. Kë-

ta nuk mund të shkëputen krejtësisht nga zakonet e traditat e së kaluarës, është e pamundur. Ata ruajnë diçka nga teket e tyre të dikurshme. I tillë është edhe Poli. Ti je vetëm një stoli për të. A më merr vesh se ç'dua të të them?».

Kjo këshillë më bënte të mendohesha. Pastaj filloja ta gjykoja fejesën time në bazë të fjalëve të Polit. Ai më kish thënë një ditë:

«Unë nuk u bëra komunist rastësisht ose pse më ishte mërziur jeta!».

Këto ishin fjalë që më detyronin të largoja çdo dyshim për Polin. Megjithatë unë nuk mbështetesha as në këshillën e Albanëzit, as në fjalët e Polit. Në fillim pandeha se e dashuroja me gjithë mend. Isha në periudhën e krizës së gjatë që pësova pas dashurisë së parë. E kuptova më vonë se nuk besoja më në dashurinë. Gjeta një justifikim: mbase nuk e njihja mirë Polin, dashuria mund të lindte me kohë. Nga ana tjetër shpresoja që me fejesën time me Polin mund të ndihmoja në vendosjen e harmonisë familjare, në zhdukjen e grindjeve midis Albanëzit dhe Zherarit. Me kohë e kuptova që gënjeja veten me këtë shpresë, se e pashë që shkaqet më të forta të grindjeve ishin politike dhe jo thjesht familjare...

DHOMA NR. 307.

Dhoma 307, në katin e katërt të spitalit, ishte bërë prej kohësh qendra argëtuese e një farë «elite të sëmurësh». Aty mblidheshin zakonisht pasdreke ose pas darkës për të kënduar me zë të ulët, për

të qeshur e bërë shaka, për të treguar historira gazmore ose për të biseduar mbi probleme të ndryshme. Një zezak nga Kameruni këndonte rumbo afrikane që flisnin për jetën e mjerë të popujve të kontinentit të zi. Një student në mjekësi ishte mjeshtër në kitarë. Por figura kryesore ishte Izidor Romeloja. Atij i kish lindur ideja për të organizuar «rrethin argëtues». Izidori ishte shtruar në spital disa ditë para meje. Kish marrë një të ftohtë në anën e majtë. Dy-tri javët e para i ish nënshtuar pa kundërshtime rregullave rigorozë të spitalit. Pastaj, kur e kish parë se po mërzitej, kish vrarë mendjen të gjente ndonjë marifet për të kaluar kohën.

— E di që! — i kish thënë një ditë zezakut nga Kameruni. — Këto pizhama sikur na e ulin dinjitetin!. Si thua?.. Një palë tuta na shkojnë më mirë.. Sikur harron që je në spital..

Zezaku e kish pëlqyer menjëherë propozimin. Pas kësaj fantazia e Izidorit shpiku marifete të tjera.

Mari-Tereza shkante shpesh në dhomën 307. Më kish thënë edhe mua që ta shoqëroja. Unë s'kisha shkuar asnjëherë. Kur kthehej në dhomën tonë, ajo do të më fliste një gjysmë ore për spanjollin simpatik. Ky avaz vazhdoi me ditë të tëra. Më në fund u bëra dhe unë kureshtarë dhe e pyeta se ç'tip ishte ky spanjolli. Mari-Tereza ma përshkroi me këto fjalë:

«Është djalë simpatik, njeri i gjallë, gazmor. Ka një aftësi të çuditshme për të imituar të tjerët. Ai ka lindur për artist. Karrierën e ka filluar si piktor. Ka qenë katër muaj nxënës i Pikasos. Tani punon si skenarist filmash. Koka i zien nga idera krijuese. Edhe në jetë sillet sikur të ishte në skenë. Çdo gjë rrotull tij është e studjuar, kërkon me ngulm e ma-

rifet që të njohë sa më shumë tipa të ndryshëm, botën e tyre të brendshme... Eja ta njohësh, Zhaklinë, dhe do të më japësh hak!».

Unë qesha me shpjegimin e Mari-Terezës. E dija që ajo i zmadhonte gjërat. Pastaj në tipin e spanjollit s'kishte asgjë të veçantë. Kështu më dukej mua. Kurse për Mari-Terezën mjaftonte një fjalë e ngrohtë e tjetrit që ajo ta shikonte me simpati. Megjithatë vendosa që të nesërmen ta shoqëroja Mari-Terezën në dhomën 307.

Hyri ajo e para, pas asaj unë. Ajo nxitoi të më tregonte spanjollin... Ngela për disa çaste e hutuar. Spanjolli ishte Izidor Romeloja që kisha njohur në sallën e banjës... Ai më pa. U afrua. Më përshëndeti me buzë në gaz. Më ftoi të ulesha pranë Mari-Terezës. Unë bëra ashtu siç më tha ai, pa folur. Izidori s'm'i hiqte sytë. Edhe unë e shikoja. Pas pak erdhi zezaku me kitaristin. Filluan nga programi i zakonshëm. Në këtë kohë e sipër erdhën edhe tre të sëmurë nga dhomat përkarshi. Unë s'e kisha mëndjen tek ata. Për çudi, Izidori dukej shumë i plogët. Mari-Tereza ishte pak e shqetësuar. Nuk rrinte mirë, s'gjente rehat. Për shkak të frakturës së lehtë në kolonën vertebrale, ajo mund të rrinte ndenjor vetëm në pozicion të shtrirë, mbështetur në shpinë. Më tha se dëshironte të luante në kitarë. U çova, i vura dy jastëkë në shpinë dhe u mundova ta ngrija pak më lart, por s'munda. Izidori më erdhi në ndihmë. Duke lëvizur, Mari-Terezës iu ngrit fustani sipër. U mundua ta shtynte drejt gjunjëve, por ai ishte mpleksur keq. Ahere Izidori mori një batanie dhe i mbuloi këmbët. Ky ishte një gjest i zakonshëm, asnjëri s'e mori për ters. Ndërsa për Mari-Terezën gjesti i Izidorit pati efekt të keq, fyes...

— E di që s'kam këmbë të mira, por. . . — dhe fjala i ngeci në fyt Mari-Terezës. Sytë iu mbushën me lotë dëshpërimi, por krenaria nuk e la që të ankohej më tej.

Izidori i vuri kitarën në duar Mari-Terezës. I tha të luante ndonjë pjesë gazmore. Ajo u përgjegj se nuk mundej dhe lotët i rrëshqitën mbi faqe.

Të pranishmit nuk po e kuptonin shkakun e dëshpërimit të Mari-Terezës. Nuk dinin ç'të thoshin për ta qetësuar. Rrinin në heshtje duke shikuar njëri-tjetrin. Vetëm Izidorit iu dha të ngrohte pak atmosferën e dhomës me një shaka të kripur. Mari-Tereza u duk sikur u qetësua pak dhe kërkoi që ta ndihmonin për të shkuar në dhomën e saj. Unë i dhashë krahun për t'u mbështetur.

Në mbrëmje pata avaze të tjera me Mari-Terezën. Mbas mesnate më zgjoi me të thirrura. Më tha të ndizja dritën. Unë isha përgjumësh dhe s'po kuptoja se ç'ndodhte. Më vonë e mora vesh të vërtetën. Ma tha me gojën e saj. . .

Mari-Tereza ishte katolike e devotshme. Megjithatë ajo kish bërë mëkata të rënda. Padashur, sigurisht! Prandaj kërkonte me çdo kusht paqen shpirtërore. . . Të gjitha këto më dukeshin qesharake, të trilluara. Por unë e ndoqa me vemendje tregimin e saj. Atë natë Mari-Terezës i kish lindur ideja e «purgatorit mbi tokë».! Tek rrinte e shtrirë në shtrat, kish ngulur vështrimin në qiell, në një drejtim të caktuar, ku nxirrte kryet herë pas here hëna e plotë. Kish sjellë ndër mend të kaluarën e saj mëkatore. Kjo ja kish lënduar keq zemrën. Menjëherë Mari-Tereza kish hedhur sytë në të ardhmen. Ideja e «purgatorit mbi tokë» e kish futur dalëngadalë në botën e ëndërri-meve. Pas një hopi lumtëria e kish marrë në krahët

e saj. Ishte një lumtëri që e kish burimin në kënaqësitë «shpirtërore» dhe jo në kënaqësitë «banale të njeriut egoist». Mari-Tereza, si dukej vuante nga halucinacionet. Aty për aty iu bë sikur ndodhej e ulur para një pjanoje në fund të një salle të madhe, gjithë dritë dhe pasqyra. Lëvizi gishtat mbi tastierë; pas pak ndjeu se po lozte serenatën e Shubertit. Mari-Tereza u tromaks. Ndaloj për disa çaste që të mblidhte veten. Por kur filloi të lozte përsëri, jashtë vullnetit të saj, ajo i binte së njëjtës melodi. U tmerrua dhe deshë të ikte. Mirëpo këmbët s'i lëvizte dot. Bërtiti:

— Oh, e zeza unë, mirë që paskam qenë në ëndërr!.. Pa dale, ç'po dëgjoj!.. Ah, po ajo!.. Po kush e luan?! Zhaklinë, Zhaklinë, zgjohu, të lutem, eja pranë meje, kam frikë!..

Ndeza dritën menjëherë. Tani Mari-Tereza ndjehej më e sigurt. U kthye nga unë dhe përgjonte me frikë, duke shikuar nga dera.

— Ja, dëgjo, Zhaklinë, a nuk luajnë serenadën e Shubertit apo më bëjnë veshët? — tha me habi dhe frikë.

Vura veshin. Nuk gabohej. U ngrita. Shkova te mjeku i rojës. Diku në katin e katërt një nga të sëmuret, që ndofta vuante nga pagjumësia, vinte manjetofonin me pjesën e preferuar. Mjeku s'mundi të zbulonte se në cilën dhomë ndodhej manjetofoni, se kur u ngjit në katin e katërt, muzika pushoi. Unë e këshillova Mari-Terezën të flinte dhe shuajta dritën.

Më keq tani për Mari-Terezën; nuk e zinte gjumi. Mbante vesh që të dëgjonte përsëri tingujt e ëmbël të serenadës së Shubertit. Ajo e shtynte të rijetonte një kujtim të bukur, të cilit Mari-Tereza

i kish vënë vulën e mëkatit. Tashma e shihte qartë se s'mund të ndahej nga e kaluara dhe qante me dënesë për t'u ngushulluar. Mari-Tereza e ndjente se prapë do të binte në mëkat, prapë do të vuante, nuk mund të ngrihej mbi «njeriun e zakonshëm», me gjithë përdëllimin e madh dhe besimin që kish te feja. Kjo gjë ishte më e tmerrshme për të.

Në mëngjez takoi te shkallët Izidorin dhe i foli për ngjarjen e natës. Aty u ndodha dhe unë. Ai sikur u trondit në fillim. Pas një hopi Izidori qeshi dhe u largua me premtimin se do ta zbulonte njeriun e bezdisshëm, që prishte qetësinë e «një vajze engjëllore dhe të bukur»!.

* * *

Mbas orës dhjetë të natës spitali binte në qetësinë e thellë të varrit. Zakonisht deri në ora një të mesnatës Mari-Tereza rrinte me sy hapur. Mendohet. Mendonte dhe qante në heshtje; ose, më mirë, vajtonte në heshtje fatin e saj të zi. Shpeshherë përpiqej t'i largonte mendimet e frikshme. E harronte mendjen me ndonjë skenë ledhatonjëse, që e vinte në gjumë. Tamam në atë çast do të ndodhte diçka: menjëherë pushonte zhurma e veturave në bulevard. Sa fillonte të mësohej me gjendjen e re, ndiheshin kërcitjet e takave të këpucëve të një gruaje, e cila herë nxitonte, herë ndalonte. Mari-Tereza e merrte me mend se gruaja ishte e vetme në mes të bulevardit, kish kaluar ndonjë aventurë para një ose dy orëve dhe tani me zemër që i dridhej nga frika pandehte se e ndiqnin... papritur bulevardi gumëzhinte përsëri nga zhurma monotone e veturave. Mari-Tereza

binte në një qetësi të rreme të shoqëruar nga tingujt e një melodie shumë të njohur. . . .

— Zhaklinë, dëgjon, Zhaklinë! . . . Apo më bëjnë veshët?! Zhaklinë, zgjohu të lutem, kam frikë! Eja pranë meje! . . . — më thirri Mari-Tereza.

Unë e kisha gjumin të lehtë. U zgjova dhe ndeza dritën te koka e shtratit.

— Ç'pate? — e pyeta pak me nervozizëm.

— Dëgjo! — tha ajo dhe ngriti dorën lart.

— Çfarë? — unë s'po kuptoja gjë.

— Prapë ajo!

— Kush?

— Serenada e Shubertit! . . .

U nevríkosa. Siç isha, me këmishë nate, dola nga dhoma. U ngjita në katin e katërt. Në krye të shkallëve pashë Izidorin. Ai rrinte ulur, me kokë të mbërthyer në pëllëmbë të duarve. Ndjeu zhurmë. Më pa. Buzëqeshi, por s'luajti nga vendi. Më tha se s'kishte gjumë. Më pyeti se ç'kërkoja. I tregova përse isha ngjitur. Izidori buzëqeshi përsëri, u ngrit, shkoi në dhomën e tij. Pas pak u kthye. Serenada e Shubertit nuk dëgjohej më. U ul përsëri te shkallët dhe m'u lut të rrija pak me të. U ula pranë tij. Ai më hodhi dorën në sup, më afroi dhe më puthi. Unë s'e kundërshtova. . . .

Gjatë kësaj kohe Mari-Tereza kish përgjuar me kujdes. Priste që të kthehesha. Unë po vonohesha. Kureshtja dhe paramendime të trubullta e shtynë të vepronte. Me zor të madh zbriti nga shtrati. Duke u mbajtur te parmakët e shkallëve, ajo po ngjitej ngadalë në katin e katërt (Mari-Tereza para disa muajve kish pësuar një frakturë të lehtë në kolonën vertebrale gjatë një aksidenti automobilistik. Për këtë shkak ishte shtruar në spital). U ndal një-

herë. Melodia që i kallte frikë, s' dëgjohej më. Vuri veshin mirë. Ndjeu pëshpëritje në krye të shkallëve. Nxitoi, duke u mbajtur vetëm me një dorë në parmakët e shkallëve...

Befas, unë e Izidori dëgjuam një «ah!», një rënkim. U larguam nga njëri-tjetri dhe pamë Mari-Terezën të rrëzuar në kthesën e shkallëve. I shkuam menjëherë në ndihmë; e ngritëm. Duke e mbajtur nga krahët, zbritëm me kujdes deri në dhomën tonë në katin e dytë dhe e vumë në shtrat. Pas kësaj Izidori i kërkoi ndjesë me një nënqeshje të lehtë, megjithëse nuk e ndjente veten fajtor për aksidentin. Ai u largua nga dhoma pa vënë re lotët dhe vështrimet e dhimbshme të Mari-Terezës. Unë shujta dritën. Ajo më foli papritur:

— Zhaklinë, mos e shuj!.. A dëshiron të njohësh aventurat e mia? Kam dëshirë të flas për veten. Më duket se kështu do ta lehtësoj shpirtin nga mëkatet, dua të rrëfhem!. Pastaj ti do të më falësh shqetësimet që të kam sjellë, kur të njohësh jetën time të mjerë. Si thua, a të pëlqen?. Të lutem, Zhaklinë, më dëgjo!

Mari-Tereza filloi rrëfimin për jetën e vet që nga fëmënia, duke mos harruar asnjë ngjarje të vogël, që lidhej me formimin e karakterit të saj... Këto janë gjëra kaq të rëndomta në shoqërinë tonë sa që më duket se s'ja vlen barra qeranë t'u vras veshët edhe të tjerëve me teket e ojnate të fëmijëve të llastuar të mikroborgjezisë. Po them disa fjalë për momentet kryesore nga jeta e Mari-Terezës.

Mbas mbarimit të studimeve, Mari-Terezës i ishte mbushur koka me parime të ngatërruara. S'kish formuar një koncept të qartë për jetën dhe ligjet

e saja. Vinte në dyshim sidomos normat morale, mbi të cilat është ndërtuar shoqëria jonë, por s'jep-te asnjë shpjegim për të qenë për këtë çështje. Nga ana tjetër, Mari-Tereza mundohej të kuptonte veten. Ndjente mirësi në zemër dhe një pasion të madh për të bukurën, por ky pasion merrte kuptimin e kënaqësive të mundshme, si një mjet për të kënaqur dëshirat e tekete e vajzërisë. Nga ana tjetër Mari-Tereza ishte edhe shumë fetare. Parimet e rrepta të fesë nga njëra anë dhe dëshirat për ta gëzuar deri në fund jetën nga ana tjetër, përbënin një nga kontradiktat shpirtërore më të thella, që brenin ndërgjegjen e saj. Në këtë gjendje të trubullt shpirtërore Mari-Tereza bëri marrëzinë e parë: dashuroi birin e një borgjezi të pasur, Gaston Manosenin, djalosh tetëmbëdhjetëvjeçar, kurse ajo në atë kohë kish mbushur të njëzetepesat. Kjo dashuri i ra në erë familjes së Gastonit. Për të mbyllur skandalin, Mari-Terezën e nisën jashtë shtetit për disa muaj. Para se të largohej, ajo e la fjalën me Gastonin që, sa herë të dëgjonin serenadën e Shubertit, të kujtonin njëritjetrin. Si u kthye nga mërgimi, Mari-Tereza vazhdoi jetën me aventura sa përfundoi në aksidentin automobilistik, që e mban të gozhduar prej disa muajve në spital. Këtu ajo u kujtua për mëkatet që kish bërë!..

— Edhe diçka tjetër, — vazhdoi Mari-Tereza. — Unë e admiroj Izidorin. Unë e njoha para teje. Izidori është gazmor, por sytë e tij duken të lodhur, po t'i shikosh me vëmendje. Qëndrimi i tij i njëanshëm (kështu i kuptonte ajo mendimet materialiste të Izidorit) karshi jetës fsheh një histori të hidhur. Nga kjo më lindi mëshira dhe nga mëshira

simpatia për të. Prandaj u trondita kur të pashë të përqaftuar me Izidorin. Të uroj, Zhaklinë! Ai duhet të jetë njeri me përvojë. Një njeri i këtille të duhet. Por dhe Izidori ka nevojë për ty. Oh, sikur të isha në vendin tënd!.. Zhaklinë, harrova diçka. Ti s'e gjete se kush e vinte atë melodi natën vonë, që më shqetësonte?... Jo?... Mirë, por unë s'besoj të ishte Izidori; do të ma thoshte!.. Shpresat s'i kam humbur edhe sot e kësaj dite, megjithëse e kam të qartë se çdo gjë mbaroi midis meje dhe Gastonit. Prandaj, sa herë që dëgjoj serenadën e Shubertit, zemra më këcen nga shpresa dhe them me vete: «Mos është ai?!». Ja, Zhaklinë, ç'desha të tregoja. Ti ke të drejtë të më gjykosh. Follmë me zemër në dorë. Kam shumë nevojë për gjykimin tënd, kështu mund të ngushëllohem... .

Mari-Tereza donte të justifikonte veten, kur më tregonte historinë e jetës së saj. Bënte çmos që të mbrohej nga qortimet që mund t'i bënin, por mbrohej keq, si palloi, që fshihet pas bishtit të tij të shpalosur... .

Duke dëgjuar Mari-Terezën, mendja më shkoi te gjendja ime. Po unë ç'po bëja? Isha në një rrugë kryq. Duhej të zgjidhja: të vazhdoja marrëdhënjet e vjetra me Pol Tenienin apo të lidhesha më ngushtë me Izidor Romelon?! . I dhashë karar që ta mendoja shtruar hallin që më kish dalë përpara.

E nisa me Pol Tenienin. Po i shikojta punët së prapthi: e filloja nga fundi që të kuptoja më mirë kreun.. «Pse po më zviridhet Poli? — thashë me vete. — Më duket antipatik tani! Ka shumë vese, zakone, por asnjë viryt!» Mos kish pasur të drejtë Albanezi kur më kish thënë se Poli ish fejuar me mua për të më pasur si një stoli?! . Pra-

nia e tij kish filluar të më mërzitë. Dikur Poli më tërhiqte me pamjen e tij të qetë, me mendimet filozofike për gëzimin e jetës. Kurse tani më dukej banale çdo gjë që dilte nga goja e tij. Solla ndër mend me neveri çdo skenë që më lidhte me Polin. Pastaj u hodha te Izidori: «Ky njeri po më tërheq, po më bën për vete. Çdo gjë tek ai, trupi i lidhur, vështrimi i fortë, mimika e çuditshme e fytyrës, gjestet e gjalla dhe heshtja e thellë, në të cilën bie papritur, shpërndajnë një hije të rëndë e magjepsëse, e cila u imponon respekt njerëzve, që rrethojnë. Ai më duket njeri me mendime të fuqishme, i sigurtë dhe i guximshëm. Këto veti do t'i pëlqenin edhe Albanëzët... Në qënjen e Izidorit ka diçka të madhërishtme!». Fjala e fundit më bëri të luaja nga vendi e hutuar dhe e kënaqur. Më lindi një ide: «Madhështia?!. Oh, ç'gjë e mrekullueshme! Madhështia dhe bukuria janë dy motra që shkëlqejnë më shumë kur janë bashkë. Unë kam bukurinë, Izidori madhështinë!»

Kështu e zgjidha këtë ngatërrësë. Anova nga Izidori. As vetë nuk e dija dhe as që mundohesha ta gjeja se ku qëndronte madhështia e Izidorit!.. Tani e kuptoj: ashtu siç po rridhnin ngjarjet, unë sikur isha e destinuar të mbaroja në krahët e Izidorit. Prandaj e gënjeja veten me gjëra të sajua-ra sipas qejfit tim. Ndofta kjo më vinte nga zakoni që kisha në atë kohë: kur fillova dashurinë e re me Izidorin, duhej të gjeja diçka të mirë, të bukur, madhështore tek ai, që të shkonte në harmoni me dëshirat dhe mendimet e mia.

TAKIM I DËSHIRUAR.

Disa ditë pas rrëfimit të Mari-Terezës, kërkova të kaloj në një dhomë më vete në katin e katërt. Dëshira m'u plotësua. Megjithatë nuk gjeta karar. Në dhomën dyshe shqetësimet m'i shkaktonte Mari-Tereza. Tani, në dhomën teke, shqetësimet më vinin nga vetëmia. Veçse këtu kisha diçka të favorshme: dhoma 307 ndodhej ngjitur me dhomën time. Atje shkoja disa herë në ditë. Më shpesh shkoja pasdreke, se një pjesë e të sëmurëve dilnin me leje. Dëshiroja të gjeja Izidorin vetëm. Kisha shumë gjëra për të biseduar me të. Më në fund m'u dha rasti i dëshiruar.

Shkova te Izidori aty nga ora pesë. Ishte vetëm, i shtrirë në shtrat; diçka po lexonte. Më vuri re kur isha pranë tij. Buzëqeshi, u ngrit, la librin mënjanë dhe më tha të ulesha në shtratin tjetër. Fytyra iu çel pak, por sytë i dukeshin të lodhur. Kjo gjë më kujtoi Mari-Terezën.

— Pse s'ke dalë? — e pyeta.

— Ku të shkoj?..

— Ku të mundesh?..

— Po ti pse s'ke dalë? — më pyeti ai.

— S'më japin leje, për shkak të kësaj — dhe vura dorën në zemër.

— A, po... Megjithatë, ti lëviz shumë!..

— E di.. Nuk mund të rri gjithë ditën në shtrat si e damllosur.. Kjo është e mërzitshme dhe më bën të trashem..

— Mërzitësh?

— Po... po ti?

— Edhe unë.

— Unë kam frikë nga mërzitja — i thashë.

— Për mua më i keq është dëshpërimi!..

— Mua më kall datën vetmia!..

Ai nuk foli. Ndezi një cigare; më dha dhe mua një.

Unë vazhdova:

— Ti dukesh i lodhur, nga sytë... Kështu thotë Mari-Tereza...

— Ajo është sentimentale..

— Izidor!.. Meqë ra fjala.. Me qëllim e vije serenadën e Shubertit?

— Për cilin?

— Për Mari-Terezën.

— Jo, ç'ne!.. Kjo ndodhi rastësisht..

— Je i interesuar të njohësh tipa të veçantë?
— e pyeta pas pak.

— Po. Këtë ma kërkon profesioni.. Përsa i përket Mari-Terezës... Në fillim unë s'dija gjë. Vetë ajo më zbuloi diçka, kur më foli e shqetësuar te shkallët për serenadën e Shubertit. Të kujtohet?. E... Pastaj desha të zbuloja ndonjë mister të sajın..

— Si të duket ajo, a është e bukur?

— Si të them?.. Varet se me ç'sy e shikon..

— Ajo m'i tha të gjitha të fshehtat e jetës së saj.

— Çudi!. Tregomë diçka!

Këtë prisja. I tregova fill e për pe gjithshka që dija për Mari-Terezën... Tamam disa çaste pasi kisha mbaruar së foluri, erdhi një infermiere. Më lajmëroi se i fejuari më priste në dhomë. Unë vështrova Izidorin. Ai më shikoi pa lëvizur asnjë dell të fytyrës. I kërkoja falje dhe u largova.

Polin e gjeta në dhomë, të ulur në karrigë.

Sapo hyra, u ngrit, më përshëndeti dhe deshi të më puthte. Unë e shikova ftohtë. Megjithatë ai buzëqeshi, s'i dha rëndësi gjestit tim. U ula në shtrat. Nuk e hapa gojën për një copë herë të madhe. S'dija ç't'i thoshja. Dhe ai, siç dukej, u ndodh ngushtë. Më pyeti pas pak për shëndetin dhe për disa gjëra të vogla. Unë përgjigjesha shkurt, pa shikuar nga ai. Mendoja se si t'ja sillja fjalën që të largohej sa më parë. Kështu do të ishte më mirë. Prapë më vinte keq për të, nuk guxoja t'ja thoshja copë. Në këto çaste më shkrepni një ide: të thërrisja Izidorin. U mata të dal nga dhoma, por Poli më zuri rrugën. Dukej i shqetësuar. Kohët e fundit vazhdimisht ja kisha shfaqur ftohtësinë time, por atë pasdreke po e tepëroja. Ai më tha se nuk kuptonte asgjë nga sjelljet e mia. Unë i buzëqesha. Me këtë e çarmatosa: i shkëputa dorën nga krahu im dhe shikova në dhomën 307. Pas pak u ktheva bashkë me Izidorin. Ja prezantova Polin sikur të ishte një i njohur, një shok. Ai i zgjati dorën Izidorit, duke më hedhur një shikim ironik. Pas kësaj Poli u gjallërua, filloi të fliste pa pushim. Bënte gjeste respekti të veçantë ndaj meje. Unë e kuptova ironinë në fjalët dhe gjestet e të fejuarit tim. Izidori s'kuptonte gjë. Mbase s'e bënte veten për të lehtësuar gjendjen time. Megjithatë unë s'e prisha terezinë. Bile u gëzova shumë kur u dha te dera Albanezi me Bernar Maikun. Këtë të fundit e njihja mirë, se vinte shpesh në shtëpi për t'u këshilluar me Albanëzin. Bernari ishte i ri komunist, punëtor në uzinën, ku kish punuar Albanezi para se të dilte në pension. Bernari mbante anën e Albanëzitet për çështjet politike.

I njoha të porsaardhurit me Izidorin. Polin e njihnin mirë. Izidori u hodh menjëherë, me entuziazëm:

— Moris Perié?!

Albanezi nuk foli, vetëm buzëqeshi, duke tundur kokën. U përgjegja unë në vend të tij:

— Po... Të kujton gjë ky emër?

— Emër i dëgjuar — tha Izidori — sidomos kohët e fundit. Unë njoh Zherarin. Mos është djali juaj?

— Po, — u përgjegj Albanezi dhe u kthye nga Poli. E pyeti për të birin se si shkonte.

— Punët s'i shkojnë keq, — tha me indiferentizëm Poli.

— Të pyes për shëndetin, pa për punët e tij jam në dijeni! — ja pat Albanezi dhe fërkoj mus-taqet. Kjo ishte shenjë nervozizmi, të cilën e mbuloi me një buzëqeshje të shtirë.

— Ç'ka, jo keq — u përgjegj Poli.

Albanezi u kthye nga unë. Menjëherë fytyra iu çel. Më hodhi krahun në supe dhe më pyeti gjer e gjatë për shëndetin, për kurat që bëja dhe si e kaloja kohën tani që isha vetëm në dhomë. Për disa minuta ai i harroi të tjerët. Më shikonte vetëm mua, më përkëdhelte. Në këtë kohë Poli u ngrit që të ikte. Ai e ndjente veten të tepërt në atë dhomë. Unë e përshëndeta me kokë dhe vazhdo-va muhabetin me Albanëzin. I fola për Izidorin Kaq deshi Albanezi: pa hequr krahun nga supet e mia, nisi të pyeste me interesim Izidorin. Sikur deshi t'i hynte në shpirt të porsanjohurit, në atë mënyrë e shikonte. Vura re se sa më shumë zgja-



tej muhabeti, aq më me simpati e shikonte Izidorin. Unë gëzohesha. Pastaj, pa u kuptuar, muhabeti kaloi në fushën e politikës. Izidori hyri drejt e në temë:

— Unë kam dashur prej kohësh të takohem me ju... Desha t'ju pyesja për disa probleme, për

të cilat po më zien koka.. Ju them të drejtën: jam i zhgënjyer nga ngjarjet e fundit në lëvizjen komuniste botërore dhe sidomos nga ato që ndodhën në Bashkimin Sovietik dhe ato që po ndodhin në Partinë tonë. Kam shumë gjëra të paqarta... Por sot ju s'keni kohë. Prandaj, në mundeni, hëpërhë të më sqaroni vetëm problemin e Shqipërisë... Kjo ishte diçka e pabesueshme për të gjithë!. Me gjithë mend, na ka ngatërruar, të paktën kështu më duket mua!...

— Ti i ngatërron vetë gjërat, more shok i dashur! — tha Albanezi dhe u kthye mirë nga Izidori — Problemi i Shqipërisë nuk është vetëm problemi i një partie! Ky është një problem që ka lidhje me gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare...

— Nuk ju kuptoj!

— Afër mendsh!.. Ç'dini ju për qëndrimin e komunistëve shqiptarë?

— Ja — tha Izidori dhe lëvizi dorën në she një të përgjithshme — Enver Hoxha, Mehmet Shehu dhe udhëheqësit e tjerë të Partisë e të shtetit shqiptar kanë devijuar, kanë dalë kundër Bashkimit Sovietik!.

— Kush jua tha këtë?!

— Si kush na i tha?. Materialet e Partisë sonë.

— Po materialet e shqiptarëve a i keni lexuar?

— Jo!

— Ahere si mund të jeni objektivë në qëndrimin karshi një partie komuniste dhe një shteti socialist duke u mbështetur vetëm në thenjet e Hrushovit?!

— Dhe të Partisë sonë — shtoi Izidori.

— Udhëheqja e Partisë sonë është bërë auto-parlant i zërit të Hrushovit në vendin tonë.

— Oh, kjo është e rëndë, shoku Moris! Ju folët tamam si borgjezia jonë, si socialistët! . Ata thonë që Partia Komuniste i merr urdhërat nga Moska! . . .

— Unë fola qartë, thashë: udhëheqja e Partisë dhe jo komunistët në përgjithësi!

— Njësoj është, më duket.

— Jo. S'është njësoj! Udhëheqja e Partisë sonë ua fsheh të vërtetën anëtarëve të thjeshtë! . .

— Ç'doni të thoni?

— O, djalosh, po na fut thellë dhe s'kemi kohë! — tha Albanezi dhe shikoi Bernarin. Pastaj u kthye nga unë: — Mos u mërzit, Zhaklinë! . .

Unë i buzëqesha dhe mbështeta kokën në supin e tij.

— Ja se ç'dua të them. . . — Albanezi iu drejtua përsëri Izidorit. Ndezi çibukun dhe vazhdoi: — Ka disa vite që kanë lindur mosmarrëveshje për disa çështje parimore ndërmjet udhëheqësve të sotëm sovjetikë, nga njëra anë, dhe Partisë Komuniste Kineze e Partisë së Punës së Shqipërisë, nga ana tjetër. . Për këtë gjë të paktën ti duhet të jesh në dijeni, apo jo?

— Kam dëgjuar diçka, por s'i kam të qarta gjërat — tha Izidori si i zënë në faj.

— Mirë, dhe këtë s'e paske të qartë! — tha Albanezi duke na bërë të qeshim me mënyrën se si i shtrembëronte fjalët nëpër dhëmbë, kur donte të shprehte pakënaqësinë që bashkëbiseduesi i tij nuk dinte çështjet themelore të bisedës. Pastaj vazhdoi: — Thamë që këto mosmarrëveshje kanë vite që kanë lindur. Kjo është një histori e tërë.

Fillin e kësaj historie duhet ta kërkojmë në kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në 1956. Që këtu filloi kthesa zyrtare e udhëheqjes sovjetike drejt revizionizmit në të gjitha fushat: në veprimtarinë e brendshme dhe në marrëdhënjet e jashtme. Partia Komuniste Kineze, me në krye Mao Ce Dunin dhe Partia e Punës e Shqipërisë, me në krye Enver Hoxhën, kur pa në kthesën e udhëheqjes sovjetike, filluan të mbajnë qëndrim në mbrojtje të parimeve themelore të marksizëm-leninizmit. Thashë: me Mao Ce Dunin dhe Enver Hoxhën në krye!... Vëri veshin mjërë këtyre fjalëve, shok i dashur! Se Hrushovi dhe ata që e pasojnë, sulmet e tyre të hapura ose nën rrogëz i drejtojnë kundër udhëheqjeve marksist-leniniste të Partisë Komuniste Kineze e të Partisë së Punës së Shqipërisë, duke pretenduar me demagogji se me vetë partitë në fjalë ata s'kanë ndonjë hesap për të larë. Me mendjen e tij prej sharlatani, Hrushovi pandeh se ka të bëjë me një-rëz naivë dhe kërkon ta kapë çemin nga brirët!... I ke lexuar artikujt teorikë të shokëve kinezë në mbrojtje të pastërtisë së markzizëm-leninizmit? Mirë, i paske lexuar; kjo është një gjë e mirë!. Ti, shoku Izidor, je në dijeni për atë që ndodhi në Bukuresht, në verën e 1960-ës në kongresin e Partisë rumune?. E, atje Hrushovi u hodh në sulm të hapur kundër Partisë Komuniste Kineze. Delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë doli në mbrojtje të Partisë Komuniste Kineze, kundra metodave fashiste të Hrushovit. Ti, shoku Izidor, e di se ç'ndodhi në mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore të botës në Moskë. Besoj se

ke dëgjuar dhe për fjalimin e Enver Hoxhës aty. E, ky fjalim ja prishi oreksin Hrushovit dhe atyre që e pasonin. Ky fjalim, mbaje mend këtë që po të them, do të hyjë në histori si një dokument i rëndësishëm dhe si një kontribut i jashtëzakonshëm i Partisë së Punës së Shqipërisë dhe i Enver Hoxhës për demaskimin e revizionizmit sovjetik e të revizionizmit në përgjithësi, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit në shkallë botërore... E shikon si kanë rrjedhur ngjarjet?. Kështu, pra, mosmarrëveshjet ishin pjekur dhe shpërthyen hapur. Megjithatë, komunistët kinezë dhe ata shqiptarë u përmbaheshin rregullave të vendosura midis partive komuniste: mosmarrëveshjet të zgjidheshin në gjirin e partive, pa i bërë të njohura publikisht, që mos t'i jepej një armë në dorë armikut... Mirëpo Hrushovi e sulmoi i pari publikisht Shqipërinë. Kështu ai shkeli vendimet e marra bashkarisht. Dhe sulmoi padrejtësisht, me shpifje të ulëta, nga tribuna e kongresit XXII të PK të Bashkimit Sovjetik. Ai arriti deri sa të bëjë thirrje për rrëzimin e udhëheqjes shqiptare. Shkurt, për kundërrevolucion në Shqipëri... Çështja e dytë: udhëheqja e partisë sonë, në mënyrë të njëanshme, e përkrahu Hrushovin dhe përhap shpifjet e tij rreth Shqipërisë. Çështja e tretë: Shqipëria u akuzua. Ajo ka të drejtë të mbrohet. Ne, komunistët e tjerë, për këtë çështje duhet të gjykojmë në mënyrë objektive, me frymë internacionaliste. Dëgjuam ç'tha Hrushovi, ç'thotë udhëheqja e partisë sonë; duhet të dëgjojmë se ç'thonë komunistët shqiptarë. Ahere të japim gjykimin tonë se nga ç'anë qëndron e vërteta, e drejta. Kështu veprojnë komunistët

e vërtetë!.. Çështja e katërt: komunistët shqiptarë, duke u mbrojtur nga sulmet e Hrushovit, duke demaskuar shpifjet e tij dhe të atyre që i venë pas qerres, mbrojnë marksizëm-leninizmin.. Po,po, kështu është. Për këtë të jesh i bindur!.. Shkurt, mbajeni mend, shok i dashur, se nga tetori i 1961-së filloi një etapë e re në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. A më more vesh se ç'thashë?

Izidori nuk u përgjegj menjëherë. Ai dukej i menduar, i pasigurt në vetëvete, sikur dyshonte për diçka!.. Pas një hopi tha:

— Pra ju mendoni se udhëheqja jonë është dogmatike?

— Më keq akoma: revizioniste!.

— Dhe për shkak të Shqipërisë, ky vlerësim që jepni?!.

— Po.. Shqipëria u bë një shkak, shkak për të kuptuar përfundimisht se udhëheqja jonë është e molepsur nga sëmundja e pashërueshme e revizionizmit..

— Vërtet, këto gjëra për udhëheqjen tonë s'i dëgjoj sot, s'është hera e parë!.. Por kurrë s'u kam besuar!

— Po tani i beson?

— Jo plotësisht, s'është lehtë!

— Po shpifjeve të udhëheqjes sonë, që përputhen me ato të shtypit borgjez kundër Shqipërisë, a u beson?

— S'di si të them!.. Edhe po, edhe jo.. Kur vjen fjala për mosmarrëveshjet në parime me shqiptarët, kjo nuk më shqetëson. Por, kur dëgjoj për terrorin, për persekutimin e komunistëve në Shqipëri, kjo më tmerron!...

— Kjo mvaret nga njeriu, nga kalitja klasore revolucionare e tij. Më duket se cilësia e fundit të mungon ty, shoku Izidor!. Një shpifje, një tri-llim dhe ti lëkundesh, më fal që po ta them, si mikroborgjezi ynë!..

— Këtë shpifje ma servir partia ime!. A më merr vesh!?

— Ti ke kokën tënde, personalitetin tënd!

— E pastaj?

— Kërko të njohësh të vërtetën!

— E si?

— Kërkoji udhëheqjes së celulës sate materialet e shqiptarëve. .

— Kam kërkuar, por s'kam marrë gjë.

— Kërkoji gjetiu dhe do t'i gjesh! Pastaj gjykoje tjetrin!

— A mund të m'i jepni ju?

Albanezi shkëmbeu një vështrim me Bernar Maikun.

— Mirë — tha Albanezi, — po të duash, mund të të japim diçka. .

— Ju lutem shumë!.. Do të më bënit nder. Kështu nuk mund të vazhdoj. Dua të njoh sa më parë të vërtetën! — tha Izidori.

Pas kësaj Albanezi dhe Bernari u ngritën. U përshëndetën me Izidorin, duke i premtuar edhe një herë se do t'i jepnin ndonjë material mbi Shqipërinë. I thanë gjithashtu se ata ishin gati ta ndihmonin për çdo gjë, atë dhe shokët e tij. Rolin e ndërmjetësit do ta luaja unë. Izidori më shikoi me mirënjohje. Dukej i gëzuar dhe nga entuziazmi erdhi bashkë me mua për të përcjellë Albanëzin e Bernarin deri në dalje të spitalit.

TIP I ÇUDITSHËM.

Izidori hëngri darkën dhe erdhi përsëri në dhomën time. Unë u ndodha para tavolinës, duke vënë në një pjatë portokallet që më kishte sjellë Albanezi. Me të hyrë, Izidori më buzëqeshi me një mënyrë të veçantë, si me tallje. Këtë gjë e pata vështirë ta kuptoja menjëherë... Izidori shkoi te dritarja dhe qëndroi disa çaste atje duke shikuar jashtë. U ula mbi shtrat dhe po ndiqja me kujdes lëvizjet e tij. U kthye nga unë, kryqëzoi duart në gjoks dhe më buzëqeshi prapë. Pastaj erdhi te komodina ime, mori një libër, shfletoi disa fletë, diçka lexoi dhe më vështroi me bisht të syrit, duke buzëqeshur si më parë. Në pamjen e jashtëme Izidori dukej i gëzuar. Ishte e vështirë të dalloje në fytyrën e tij të qeshur nuancat e padukshme të ironisë. Këtë gjë ma lehtësoi një skenë e vogël, që u zhvillua pak më vonë. Me këtë rast ai qeshi me zemër, i qeshën edhe sytë. Unë munda të bëja krahasimin midis dy fytyrave të qeshura dhe të dalloja kështu ironinë ose sinqeritetin në buzëqeshjet e tij. Skena u krijua në këtë mënyrë: që nga komodina Izidori shkoi para tavolinës. Mori një portokalle, thikën dhe, kur e kish mbaruar së qëruari dhe po fuste thelën e parë në gojë, më tha:

— Më lejon? — e kishte fjalën për të marrë një portokalle.

Në çast Izidori ja dha të qeshurit me gjithë zemër, se u kujtua që fjalët e tij tashmë s'kishin kuptim, sepse portokallen po e hante dhe leje duhej të kërkonte para se ta merrte. Qesha dhe unë bashkë me Izidorin. Qesha më shumë nga marifeti

që kishte ky njeri për t'u familjarizuar aty për aty me tjetrin. Dhe më erdhën ndër mend fjalët që më kish thënë Mari-Tereza për Izidorin:

«Në tipa si spanjulli është e vështirë të kuptosh se kur flasin me gjithë mend dhe kur e kanë me shaka! Është e vështirë të dallosh ironinë nga lëvdata. Më e vështirë është akoma të njohësh ndjenjat dhe mendimet e tyre. Prandaj shumë të sëmurë i merrnin për të keq fjalët e spanjollit në fillim, kur s'e njihnin. U desh pak kohë për të kuptuar sa argëtues ishte ai, sa e këndëshme ishte shoqëria me të!.. Tani asnjë nga të sëmurët nuk e ndjen veten të fyer nga shakatë e tij të rënda.

Izidori u ul karshi meje dhe më pyeti:

— Poli është i fejuari yt?

— Po! — iu përgjegja unë e pakënaqur që ai e hodhi fjalën te i fejuari.

— Duket djalë i mirë.

— Mundet.. Për mua është njësoj!

— Ah!. Pse?!. Ai të respekton! Bile pak si tepër..

— E pastaj?!

— Nuk e dashuron Polin?!

— Jo!

— Pse?

— Sepse nuk është i sinqertë me mua!..

Izidori buzëqeshi, por jo me tallje si në fillim. Buzëqeshi i kënaqur. Këtë e vura re mirë dhe m'u bë qejfi.

— Moris Perieja është babai yt, apo jo? — më pyeti përsëri Izidori, duke më shikuar në dritë të syrit.

— Jo, është kujdestari im, ai më ka rritur.

— Si kështu?!

I shpjegova shkurt se ç'lidhje kisha me Albanezin. Nuk harrova t'i thoshja se isha e kënaqur që jetoja nën kujdesin e tij.

— Po në kontradiktat midis xha Morisit dhe Zherarit ti ç'anë mban?

Mua më bëri të qesh fjala «kontradiktë». Kjo më dukej pak abstrakte, kur hynte në marrëdhënjet familjare. Izidori më pyeti:

— Pse qesh?

— Nga kontradiktat!..

— Merre si të duash! Por unë them se...
— ai u mendua për një çast, pastaj: — se grindjet midis tyre kanë karakter politik, jo thjesht familjar.

— Ashtu më duket dhe mua... Dhe, të të them të drejtën, më vjen keq që ndodhin këto!..
— Ti ke nevojë për qetësi, të paktën kur je në shtëpi?

— Po, që të mund të merrem me hallet e mia.

— E, si e ke zgjidhur këtë problem, ç'anë mban?

— Unë nuk marr pjesë në grindjet e tyre — i thashë dhe i bëra me dorë që ta linim këtë muhabet. Izidori nuk dëgjoi. Më pyeti përsëri:

— Kush ka të drejtë, si mendon ti?

— Nuk e di!

— Mirë. Tjetër njeri keni në familje?

— Po.. Luizën, motrën e vërtetë të Zherarit.

— Dhe bijën e vërtetë të xha Morisit, apo jo?

— Ashtu është.. Thashë motra se pikërisht ajo është kundër të vëllait dhe e dënon atë më rëndë se sa i jati!

— A, ajo i jep të drejtë xha Morisit?

— Sa për Luizën është e kotë ta zgjatim muhabetin. Ajo ja thotë vetëm në politikë!..

— Kurse ti ja thua vetëm në dashuri! — tha me ironi Izidori dhe më shikoi me ngulm.

Këto fjalë më bënë që të mendohesha një copë herë, m'u dukën të çuditshme. Kurrë s'e kisha vrarë mendjen se ku ja thoshja më tepër dhe në dija të bëja dashuri apo të lozja me dashurinë. E pashë që nuk mund t'i përgjigjesha drejtpërdrejt Izidorit. Prandaj e ktheva muhabetin në një rrugë tjetër. Fillova ta pyesja unë:

— Ti je komunist, Izidor?

— Po.

— Pse u bëre komunist?

— Nuk mundem të ta shpjegoj me pak fjalë.

— Po si u bëre komunist, a mund të ma thuash?

— Edhe kjo është histori e gjatë, por mund të përgjigjem që tani. Më pëlqen të rikujtoj të kaluarën.

— Ahere po të dëgjoj!

— Do të kesh durim?

— Do të përpiqem..

Izidori mbuloi fytyrën dhe një copë herë të madhe qëndroi ashtu, në qetësi, pa lëvizur. Unë s'e kuptova këtë gjest. Më vonë ja njoha zakonin: në çastet, kur pushtohej nga emocionet, Izidori nuk e kishte zakon të hidhte vështrimin diku larg, por mbulonte sytë me pëllëmbët e duarve dhe në atë gjendje mendohej të krijonte hapësirën e pafund, të nevojshme për parafytyrimet, që i buronin nga fantazia e ndezur. Izidori zbriti nga shtrati dhe, duke bërë ecë e jakë nëpër dhomë, filloi të tregonte:

të të shpjegoj këtë betejë të përgjakshme, të cilën e fituam. Këtu njoha dhe kuptova forcën e komunizmit!. Kjo ishte etapa e fundit... Ja, e shikon se si u bëra komunist, Zhaklinë?! . A nuk të duket si trillim kjo që të tregova?..

— Jo, aspak! — i thashë.

— Ahere më kupton?

— S'di ç'të them!. Por unë të besoj ty, Izidor!..

Unë me gjithë mend i besoja, ose, kisha filluar t'i besoja. Tek ai çdo fjalë, çdo gjest, çdo mendim, më dukej i vërtetë, real, i besueshëm. Kjo gjë më hutoi. Ndjeva një farë ndrojtje karshi Izidorit. Megjithatë nuk iu largova. Përkundrazi, tani ndjeva një nevojë jetike për të qenë sa më pranë Izidorit, sa më shpesh me të. Dhe kjo më ndodhte se ai më ngjalli në zemër guximin me shembëllimin e tij... Guximi ka lidhje drejtpërsëdrejti me të vërtetën. Guximi më shtynte të zbuloja, më në fund, të vërtetën e jetës sime...

BISEDOJ HAPUR

Kam pasur gjëra për të cilat kurrë nuk kam dashur të flas. Mirëpo, kur zura miqësi me Izidor Romelon, punët ndryshuan. U bëra më e hapët me njerëzit, nuk mbaja shumë rezerva. Bile shpesh e qortoja rreptë veten, kur ngurroja të flisja hapur... Në fillim këtë ndryshim unë e shikoja me frikë. Por nga bisedat e gjata me Izidorin fitova pak nga pak sigurinë. Ciltërsia e tij më bëri për vete dhe më shtoi besimin për të ecur pa frikë në rrugën që më ishte hapur.. Me-

gjithatë, këtu puna s'qëndronte kaq thjesht, siç dukej. Karshi meje edhe Pol Tenieni ka qënë i singertë (sipas mënyrës së tij, kuptohet), porse unë me të, të shumtën e rasteve, kam folur duke kafshuar gjuhën. Ndërsa me Izidorin flisja me zemër në dorë për disa shkaqe: se ai ishte vetë i giltër (çiltërsia e tij ndryshonte nga «singëriteti» i Polit); se admirova virtytet dhe u mësova me veset e tij; se atë, më në fund, e dashurova.

Rreth marrëdhënjeve të mia me Mari-Terezën hapët për herë të parë bisedova me Izidorin. I fola hollësisht për shqetësimet që më kish shkaktuar ajo me tekat e saj të mërzitshme. Pastaj e pyeta:

— Përse, kundër zakonisht, unë të kam folur shpesh dhe gjatë për Mari-Terezën?

— Ti ke disa dobësi të përbashkëta me të; pak, jo shumë! — u përgjegj me të qeshur Izidori, por fjalët e tij m'u dukën me vend.

Kaq më tha. Më tej s'e ngacmova për këtë punë. Më vonë fjala erdhi edhe për marrëdhënjet e mia me Pol Tenienin. I tregova fill e për përrugën që kisha kaluar derisa arrita të fejojhesha me të. Kur i fola për shkaqet që më shtynë të fejojhesha me Polin e ndërmyjet tyre përmenda edhe «shkakun politik apo familjar» — (fejësja me Polin mund të ndihmonte në pajtimin e Albanëzitet me Zhe-rarin — këtë profkë as vetë nuk e besojta), Izidori qeshi me tallje. Më në fund i thashë se kisha vendosur ta prishja fejesën me Polin. Izidori më pyeti, prapë me ironi:

— Për shkaqe politike, ndofta?!..

— Jo, — i thashë unë. — Kjo punë kështu u nis dhe kështu do të mbarojë!

Më tutje nuk vazhdova.

Biseda për grindjet midis Moris Periesë dhe të birit ngjalli kërsërinë e Izidorit. Ai m'u lut që t'i flisja sa më gjatë për këtë histori, duke më nxituar me pyetje herë pas here. Vija re se sa më shumë flisja për xha Morisin aq më tepër zmadhohej figura e tij para syve të Izidorit. Në këtë mes kishte dhe diçka tjetër: unë flisja me adhurim për xha Morosin, e nisur nga dashuria e madhe që kisha për të si prind. Kurse për Izidorin ishte më interesante figura e xha Morisit si komunist militant se sa si njeri humanitar, apo si kujdestar i përsosur karshi meje. Dhe këtë gjë e vura re më vonë. Izidori kish një cilësi të veçantë: ai kapej pas momenteve kryesore të ngjarjes apo të jetës së një personi, pas pikave kulminante, dhe në bazë të tyre vlerësonte çdo gjë. Izidori u entuziazmua menjëherë, kur i tregova një ngjarje të vogël midis xha Morisit dhe Zherarit. Më tha që ta përsëritja skenën e grindjes atë e bir. Unë s'po kuptoja se ku qëndronte bukuria e kësaj skene. Kisha dëgjuar sa e sa herë që ata të grindeshin për probleme politike. Aty s'gjeja asgjë të jashtëzakonshme. Ngjarja ishte shumë e thjeshtë: një ditë xha Morisi kish shkuar në zyrën e Zherarit dhe, në prani të komunistëve të tjerë, i inatosur, i ish drejtuar të birit:

«Edhe sikur të gjithë ju, edhe sikur e gjithë partia jonë të dalë kundër Shqipërisë, unë do të jem me Shqipërinë! Ajo ka të drejtë! Mbani mend fjalën e plakut! E vërteta është me komunistët shqiptarë e kinezë, me Mao Ce Dunin e Enver Hoxhën!...».

— Ka pasur hak Zherari që e ka mbiquajtur të atin Albanez!, — tha Izidori, duke tundur kokën me të qeshur.

Në një rast tjetër unë i fola për këshillat e urta që më jepte herë pas here Albanezi lidhur me qëndrimin tim karshi jetës politike. Albanezi më thoshte:

«Ti je e re, Zhaklinë, ke forca të mëdha dhe patjetër detyrohesh t'i vesh në veprim këto forca. A më kupton? E tillë është mosha e rinisë, ajo duhet t'i harxhojë forcat e saj, do të merret me diçka, pa derman!. E gjithë puna këtu është që ti të gjesh rrugën tënde. Me se të merresh? Me dashuri?! Kjo s'mjafton për jetën e njeriut! Me se tjetër? Me dëfrime? Edhe kjo jetë është një kupë me helm, që të çon në degjenerim. Vetëm rruga e revolucionit është rruga e vërtetë, që duhet të ndjekë një i ri i ndershëm. Ajo është e vështirë, por e bukur. Këtë ta thotë një plak, që gjithë jetën ja ka kushtuar revolucionit. Mos harro babanë tënd!..».

Unë i buzëqesha me respekt. Në këto raste më kujtohej Luiza. Thosha me vete: «A mund të bëhem edhe unë si ajo?..».

Këto gjëra i tregova Izidorit. Atij i lanë mbresa të veçanta. Përsëriti me vete: «E tillë është mosha e rinisë, ajo duhet t'i harxhojë forcat e saj, do të merret me diçka, pa derman!». Pas një hopi, tha:

— Ky është mendim interesant, është esenca filozofike e jetës së rinisë!.. Sa fjalë me vënd ka thënë Albanezi yt, Zhaklinë!..

Unë mendova:

«Kjo është analizë filozofike për jetën time?!».

LARGIMI NGA SPITALI

Ditën që do të dilja nga spitali isha shumë e trishtuar. Kisha bërë gati valixhen, isha veshur dhe po prisja që të më telefononte Albanezi. Pada-shur, në këto çaste, më shpëtuan nga goja fjalët: «Tungjatjeta trishtim!». Qesha me tallje (si Izidori), por dëshpërimi nuk m'u largua... Kaloi një gjysmë ore. Po humbisja durimin. E mira ishte të largohesha sa më parë nga spitali që të shpëtoja për një farë kohe nga kthetrat e trishtimit. Shkova në infermeri dhe telefonova. Luiza më tha se së shpejti do të vinin të më merrnin.

Shkaku i dëshpërimit ishte largimi nga Izidori. U mësova me të, doja ta kisha gjithmonë pranë. Spitali na jepte mundësi të takoheshim orë e çast. Jashtë tij s'e kisha të qartë se sa të përshtatshme do të ishin rrethanat për t'u takuar. Veçse me mend bluaja diçka, që ja fshihja dhe vetes nganjëherë. Unë do të bëja gjithë përpjekjet për të pasur Izidorin gjithmonë pranë meje. Fundja, po ta shihja pisk, mund të martohesha me të së shpejti. Kjo dëshirë m'u kthye dalëngadalë në një qëllim dhe më udhëhoqi deri në ditën që u vra Izidori. Nën hijen e kësaj dëshire unë jetova disa ditë të lumtura, të paharrueshme....

Në këtë gjendje më gjeti Izidori kur erdhi në dhomën time. Sapo isha kthyer nga infermeria dhe isha shtrirë në shtrat. U mundova t'i buzëqeshja. Ai buzëqeshi. Kjo sikur më solli në vete. Më tha se më kish pritur në dhomën e tij për të biseduar. Unë s'iu përgjegja.

— S'bëhesh kureshtarë?!. — më pyeti.

— Përse?

— Të dish se ç'dua të të them.

— Jo... Jam e mërzhitur.

— E shoh. Por kjo s'të pengon që të më dëgjosh..

— Mirë, folë, Izidori! — i thashë dhe u ngrita nga shtrati. Shkova të ulesha në një karrigë pranë tij. Ai po më vështronte me vëmendje. I hodha një sy vetes. Atë ditë kisha veshur një palë tuta sportive. Vura re se Izidori i kish ngulur sytë në gjoksin tim. U trubullova. Ai më pyeti:

— Pse i veshe këto?

— Nuk e di! — thashë unë. Pastaj: — Pse, s'të pëlqejnë?

— Përkundrazi.. Ta tregojnë trupin shumë të zhdërvjellët, se të rrinë pak të ngushta. Dukesh si ato zanate detit, gjysmëpeshke gjysmë njeri!..

E pikasa ironinë e tij. Kjo i vinte nga dëshpërimi. Prandaj e lashë të vazhdonte. Izidori sikur e thithi mendimin tim. U ngrit; shkoi te dritarja dhe qëndroi atje për disa çaste pa folur. Diçka bëhej gati të thoshte, diçka me rëndësi. Ja njihja zakonin. Megjithatë unë po prisja me ankth.

— Zhaklinë, të lutem çohu!.. Ashtu, mos lëviz!.. Ti je e dëshpëruar... Edhe unë jam i mërzhitur. E di përse jam i mërzhitur?... Nga që po largohesh!. Por nuk jam j sigurt: a duhet të mërzhitem që po largohesh ti?!..

— Kurse unë jam e sigurt: për shkakun tënd më ka kapur trishtimi! — thashë pa luajtur nga vendi, siç isha në këmbë.

— Prit, të lutem mos folë, mos luaj!. — Ai m'u afrua aq sa unë ndjeja frymëmarrjen e tij. Më kapi nga krahët. — Zhaklinë, po ta them hapur.. Kështu të kam folur gjithnjë.. A e di ti se ç'mendoj unë në këto çaste?

— Jo, s'kam se si ta di.

— Të shoh kështu dhe më kap dëshira të të rrëmbej, të të çoj në shtëpinë time, përgjithmonë!...

— Unë nuk do të ngurroja, Izidor. Por s'e di a është koha për ta bërë këtë punë..

Izidori nuk u përgjegj. Shkoi përsëri te dritarja dhe aty qëndroi një copë herë pa folur. Mua prapë më kapi trishtimi, u bëra melankolike. I thashë se më vinte keq që po largohesha nga spitali, se e kishim kaluar mirë aty dhe i premtova një takim të afërt. Ai prapë s'foli; më vështroi, buzëqeshi dhe papritur m'u afrua, më përshëndeti, duke më shtrënguar dorën dhe u mat të ikte. Unë s'e lashë. Ahere ai më puthi dhe më ra krahëve me përkëdheli. Pas kësaj u largua. Në këtë çast e ndjeva veten të mitur dhe më erdhi për të qarë.

* * *

Në spital erdhi vetë Albanezi të më merrte me taksi. Unë prisja që të vinte Luiza. Mirëpo ajo qëndroi në shtëpi me disa shokë, që kishin shkuar për t'u këshilluar lidhur me manifestimet e fundit të studentëve. Gjithë rrugës deri në shtëpi nuk nxora një fjalë nga goja dhe ndenja me kokë të kthyer mënjanë që të mos hasja vështrimin pyetës të Albanazit. Ai u tregua i mirë me mua, nuk më bezdisi, nuk më pyeti për shkakun e mërzitjes që më kishte pushtuar.

Shtëpia jonë ndodhet në një lagje punëtorësh në periferi të qytetit. Shtëpia është me dy kate, e ndërtuar simbas stilit të vjetër me çati të pjerrët; muret nga jashtë janë të veshura me pllaka guri, që janë nxirë nga koha. Në katin e parë është bufeja me anekset e saj. Banaku shtrihet së gja-

ti sallës dhe sheh nga porta kryesore e hyrjes. Prapa banakut rri Albanezi, që fërkon mustaqet e zverdhura sa herë që u jep udhëzime kamerierëve për t'u shërbyer shpejt klientëve. Në rast nevoje Albanezi shërben vetë. Bufenë Albanezi e ka pasur shumë vjet para se të dilte në pension. Ajo ka shërbyer gjithmonë si qendër për grumbullimin e punëtorëve. Aty janë bërë planet e disa grevave. Sidomos gjatë periudhës së Frontit Popullor, në 1936, në bufenë e Moris Periesë mblihdeshin udhëheqës komunistë e të sindikatave për të bashkërenditur planet e veprimit. Shumë punëtorë mblihdhen në bufenë e Albanëzit edhe gjatë fushatave elektorale. Kështu bufeja kthehet shpeshherë në sallë diskutimesh. Për këtë qëllim Albanezi ka caktuar sallonin në katin e dytë. Shokët vijnë në bufe, hedhin nga një gotë dhe që aty, nga një derë e brendshme, ngjiten për në sallonin e mbledhjeve.

Porta kryesore e bufesë të nxjerr në trotuarin e rrugës më të populluar të lagjes. Prapa shtëpisë është oborri i vogël dhe garazhi për veturën e Zherarit. Tani garazhi është bosh. Zherari u largua nga shtëpia që kurse plasën grindjet me të atin. Zherari banon tani në një vilë të vogël jo shumë larg nga shtëpia atërore.

Në katin e dytë janë dhomat e gjumit dhe kuzhina. Dritaret e dhomës sime shikojnë nga rruga. Dhomën e kam mobiluar sipas fantazisë sime të moshës së njomë, që kur isha katërmbëdhjetë vjeç, qysh ahëre kur lexoja me etje romanet e Aleksandër Dymait: perde të lehta në dritare; aty pranë, shtrati me dy radhë raftesh për libra

në krye, në faqen e murit një sixhade e gjatë sa shtrati me ngjyra të çelura, tavolina e punës pranë dritares tjetër dhe rafti i madh për libra. Në mes të dhomës një tavolinë e rrumbullakët me katër kolltuqe të vjetëra, që i japin dhomës një hije të rëndë bashkë me dollapin e rrobave, por që shkojnë në harmoni me stilin e mobiljeve të tjera të dhomës sime...

Luiza na priste para bufesë. Taksia u ndal para portës kryesore. I pari zbriti Albanezi, pastaj dola unë me përtim dhe me pamje të lodhur. Luiza, posa më pa, u turr drejt meje dhe m'u hodh në qafë. Unë vetëm i buzëqesha për një çast dhe ndoqa Albanezin. Më erdhi pak bezdi nga entuziazmi i Luizës. Ajo foli gjithë optimizëm për shëndetin tim, duke dashur të më jepte zemër... Albanezi qëndroi në bufe. Unë u ngjita vetëm në dhomë. Pas një çik, kur kisha vënë këmbën në prak të dhomës sime, kisha hapur derën dhe po hidhja një sy brenda në gjysmërrësirën për shkak se perdet s'ishin hapur, mbërriti Luiza me valixhen në dorë. Ajo donte të hynte brenda që të hapte perdet e dritareve. Unë s'e lashë. E falenderova dhe i thashë të më linte vetëm. Luiza la valixhen dhe u largua e pakënaqur. Ahere më erdhi keq për të, u pendova që u solla aq e ftohtë. Mirëpo ky mendim nuk më mundi gjatë. Hyra në dhomë, hapa perdet, hoqa pardesynë dhe rashë në shtrat... Lëvizjet e automjeteve dhe të këmbësorëve në rrugë reflektoheshin me hije të gjata në tavan nëpërmjet dritareve. Unë isha në gjendje të dalloja objektin që kalonte në rrugë në ishte veturë apo njeri, jo vetëm nga zhurma, por edhe nga

forma e hijes. Kjo gjë më bindi se unë mund të dalloja me anë të hijeve në tavan edhe njerëzit që nga mënyra e tyre e të ecurit. Ky mendim m'u ngul në kokë. Kështu, hapja sytë që me anë të hijeve të kuptoja se mos kalonte në rrugë Izidori. Kjo dëshirë m'u kthye shpejt në një shpresë reale dhe njëherë brofa nga shtrati, kur pashë në tavan të lëvizte një hije, e cila m'u duk si hija e Izidorit. Shkova me vrap në dritare, shikova me vëmendje andej-këndej në rrugë... Asgjë!... Sigurisht që hija e njohur ishte një mashtrim ose, më sakt, trillim i mendjes sime. Kjo gjë më nevrikosi dhe pas disa çasteve qortova veten: Sa budallaqe që jam!.. Përse gënjehem me iluzione të kota?.. Sikur me të vërtetë Izidori të kalonte në rrugë, unë duhej të rrija këtu në dritare dhe jo të shikoja hijet në tavan!..». U dëshpërova. I ktheva kurrrizin dritares. Shikova me radhë mobiljet. Të gjitha më dukeshin hijerënda, të demoduara, që krijonin një ambient mbytës në dhomë. S'më bëhej të rrija brenda. Syri më kapi padashur një rreze dielli, që binte në këmbët e mia. Ahere u kujtova të shikoja qiellin... Grumbuj resh të zeza, që vinin nga perëndimi, vraponin si të çmendura në drejtim të lindjes. Ato e lejonin herë pas here diellin të hidhte disa rreze të arta mbi qytet. Kjo ishte një gjë e rrallë për ne, që na qan syri për të parë në dimër një rreze dielli. Era, që frynte, paralajmëronte shtërngatë... Ah sikur të shpërthente që në atë çast shtërngata!.. Kështu do të ishte më mirë; më mirë një shi i fortë, i rrëmbyer, të zbrazej qielli njëherë e mirë se sa mjegulla e mërzitshme, që zakonisht zbriste deri në kulmet e çatave dhe

e shtypte qytetin me peshën e saj, u zinte frymën njerëzve me lagështirën e ftohtë...

Izidori thoshte:

Një revolucion i vërtetë dhe çdo gjë merr fund me këtë borgjezi të kalbur!..».

Unë nga ana ime uroja:

«Një shtërngatë e vërtetë dhe mjegulla do të marrë fund njëherë e mirë!..».

Por a mund të ndodhte kjo gjë?! Jo! Pas shtërngatës mjegulla mund të largohet për disa ditë. Vetëm për disa ditë ose për një ditë. Këtë gjë e dija. Ky është një fenomen i natyrës dhe njeriu është akoma i dobët karshi saj... Po njeriu me njeriun?!.. Edhe këtu hyn forca, ajo përcakton zhvillimin e ngjarjeve. Njeriu, që ka forcën në dorë, bëhet zot mbi tjetrin. Izidori thoshte se, me anë të revolucionit socialist, forca do të kalojë në dorë të proletariatit... Po ky a mund ta mbajë këtë forcë përgjithmonë?!.. Për këtë Izidori s'më kish folur deri atëhere dhe ishte çështja më e rëndësishme... Ja, pra, se unë kisha shumë gjëra për të biseduar me të...

Kështu më ndodhte nga herë: do të gjeja një shkak për të sajuar mundësitë që të ndodhesha pranë Izidorit. Dëshira për të njohur këtë apo atë problem politik ose shoqëror pleksej me dëshirën për të takuar Izidorin. Mua më interesonte ai më shumë se sa idetë e tij. Kështu ndodhte në fillim. Por, dalëngadalë, edhe idetë e Izidorit po bëheshin interesante për mua, e po më rrëmbenin.

E pashë se s'mund të rrija asnjë minutë më tepër në dhomë. Shkova te dollapi i rrobave, veshja pardesynë, mbështolla flokët, kapuç, pastaj

dola nga dera e prapme e shtëpisë pa rënë në sy të njerëzve. Me t'u ndodhur në rrugën e gjerë, mendimi i parë që më erdhi në kokë ishte për Izidorin dhe desha të mbaja frymën në spital.

Një lëmsh m'u mblodh në grykë dhe më zuri frymën. Këtë lëmsh të rejat e njohin mirë, e adhurojnë, se ay u jep krahë, i bën të lumtura, u jep një lumturi që s'blehet as me flori, lumtëri që nuk e provon dot gjithë jetën! Të moshuarat mbase qeshin ose tallen me lëmshin e të rejave; tallen kur përpiqen të mos shohin lëmshin tjetër, të pleqërisë, që u mblidhet rreth fytit. Lëmshi i dashurisë ka vetëm një të keqe: të pret oreksin!.. Mirëpo unë, në ato çaste kur solla ndër mend Izidorin, nuk isha duke ngrënë. Isha ulur në një stol buzë rrugës, kisha varur kokën prapa dhe, me sy të mbyllur, rikujtoja skenat më të bukura që kisha jetuar me Izidorin. Një forcë e papërmbajtur më shtynte drejt krahëve të tij: ta pushtoja, të shfryja dufin e zemrës së zhuritur, pastaj ta përkëdhelja me dashuri, me ëmbëlsi dhe të vështroja me im-
Veçse zemrën e furishme e për-tësi tiparet e tij!.. mbante mendja e urtë. Zemra dhe mendja grin-den shpesh njëra me tjetrën. Megjithatë, mendja, si një nënë e urtë dhe e durueshme, e bind zemrën. Shumë mirë që ndodh kështu, ndryshe njeriu do të bënte nëntëdhjetë budallallëqe në njëqind veprime!

I dhashë karar që asaj dite nuk duhej të shkoja në spital, nuk bënte. Ky ishte një vendim i vështirë. Dhe, për të harruar mendjen, hyra në një stacion të metrosë. Që aty dola në stacionin Luksemburg, në bulevardin e Studentëve, me qëllim që të

takoja shokët e shoqet e fakultetit. Nuk vura re menjëherë që atje diç po zjente. Padashur u për-zjeva me turmën e madhe të studentëve, të cilët kishin mbushur bulevardin. Qarkullimi i veturave ishte ndërprerë. Pranë parkut të madh «Luksemburg», pashë një grup policësh me shkopinj gome në duar. Ata rrinin të heshtur, të qetë, por me shikime të rrepta... Studentët e fakulteteve të ndryshme të Universitetit qysh në mëngjes kishin shpallur grevë, duke kërkuar përmirësimin e kushteve të studimit dhe shtimin e fondeve në favor të arësimit. Në fillim greva e tyre kishte karakter paqësor, pa zhurma të mëdha. Nga greva ndënjur para Universitetit, në drekë studentët u grumbulluan në bulevardin e madh për të marshuar në formë demonstrative. Mirëpo kolonat e studentëve u ndalën në krye të bulevardit nga grupe policësh. Dukja e policëve e nxiti më tepër ndjenjën e revoltës të studentëve. Aty-këtu, në grupe të veçanta, ngriheshin studentë sipër ndonjë veture të blokuar në rrugë, ose mbi supet e shokëve dhe mbanin fjalime të shkurtëra, duke hedhur parulla mobilizonjëse. Gjendja sa vinte e po acarohej më shumë. Kolonat e studentëve e shtynin ngadalë, por e shtynin ama, murin e policëve. Ardhja papritur e një grupi xhandarësh në ndihmë të policëve shkaktoi, në fillim, një farë ngurrimi në rreshtat e para të studentëve. Veçse me kacafytjen e parë plasi edhe përlëshja e vërtetë.

Midis turmës së studentëve unë u ndjeva si në shtëpinë time. Atmosfera e elektrizuar e bulevardit po më tërhiqte gjithmonë e më thellë në qendër të saj. Zati edhe unë vetë e kisha shpirtin plot

tallaze. Kështu, pa e kuptuar as unë vetë, u ndodha në rreshtat e para të demonstruesve. Një student u përplas në këmbët e mia nga një goditje e fortë. Unë u ula, e kapa nga krahët dhe, kur ai u ngrit me fytyrë të gjakosur, thirra si e marrosur, duke iu drejtuar xhandarëve: «Kriminelë!». Thirrja ime u tret, humbi pa u ndjerë në zhurmën shurdhonyesë të kacafytjeve. Dy studentë u afruan për të ndihmuar shokun e plagosur. Njëri nga ata nxori shaminë me qëllim që të fshinte një çurk gjaku, që kullonte mbi syrin e majtë të të plagosurit. Unë s'e lashë. Kapa të plagosurin nga krahu, e tërhoqa dytre hapa dhe, duke ua treguar xhandarëve, desha të protestoja për këtë poshtërsi, për këtë padrejtësi!. Gjesti im i bëri njerëzit, që ishin aty rrotull, të qeshnin. Kjo qeshje m'u duk cinike. Mirëpo pashe se dhe shokët e mi kishin vënë buzën në gaz dhe më shikonin në një mënyrë sikur donin të më qortonin. Vështrimi kuptimplotë i shokëve më solli në vete, e kuptova naivitetin tim dhe e lëshova me turp krahun e të plagosurit. Ky më buzëqeshi me dashamirësi. Ahere unë hoqa nga qafa shallin e hollë, i fshiva gjakun rreth plagës dhe u mata ta hidhja përdhe shallin e gjakosur. I plagosuri më tha që t'ja falja si kujtim shallin dhe më pyeti si më quanin dhe në ç'fakultet studjoja. Unë i tregova. Ai më falenderoi duke më shtrënguar doren. **Pas kësaj u ndava nga i plagosuri. Desha të largohesha.** Por s'kisha nga të çaja. Rreshtat e studentëve sa vinin e ngjisheshin më shumë. Kështu, dalëngadalë, u gozhdova pas murit të një ndërtese. Fryma po më merrej, s'kisha nga të lëvizja. Në çast e ndjeva rrezikun dhe m'u kujtua rasti i lzi-

dorit te shkallët e stacionit të metrosë. S'dija ç'të bëja, kujt t'i kërkoja ndihmë. Thirra njëherë e tmerruar, në çastin kur po më shteronin forcat e fundit. Tre studentë, që kishin bërë barikadë para meje, bënë një përpjekje të dëshpëruar: shpërthyen me forcë në një drejtim dhe hapën një shteg sa që mezi munda të kaloja. Tani ndodhesha midis një grumbulli studentësh nga rreshtat e fundit. Rreziku ishte më i vogël. Ndjeva në ato çaste se dikush po më tërhiqte nga krahu. Unë i bindesha dhe, ngaqë isha e hutuar, nuk vura re se kush ishte ai, që më tërhiqte me aq forcë e aq ngulm. Vetëm kur dolëm jashtë çdo rreziku, e njoha Pol Tenienin. Të dy bashkë hymë në një bufe në krye të rrugës, në bufenë «Martirët e kombit». E lashë Polin në një tavolinë në cep të sallës nga hyrja dhe shkova drejt e në dhomën e tualetit për të ndrequr veten. Po shikohesha në pasqyrë me habi. Isha zverdhur në fytyrë; fustanin në gjoks ma kishin shqyer, flokët ishin mpleksur keq. U rregullova shpejt e shpejt (bluzën e mbërtheva deri në grykë që të mbuloja gjoksin). Për të ngushëlluar veten, solla ndërmend tablonë «Liria mbi barikadë». Mora të njëjtën pozë sikurse ajo grua e re guximtare me gjoks të shqyer, që ngre lart flamurin e lirisë mbi barikadë. U pashë në pasqyrë: dukesha qesharake! Megjithatë, ky përfytyrim më qetësoi pak, sikur e justifikoi pjesëmarrjen time në përleshjen e studentëve me xhandarët.

Polin e gjeta po në atë tavolinë ku e kisha lënë, duke thithur cigaren i menduar, i mërzitur. Më vështroi një copë herë të vogël me qortim, pa folur. Pastaj më pyeti në do të pinim diçka. Porosita një kafe; ai një gotë birrë.

— Kur ke dalë nga spitali? — më pyeti Poli qetë-qetë.

— Sot...

— Sot! Dhe erdhe këtu në këtë rrëmujë?!

Unë s'fola. Në këto çaste erdhi kamerierja që pruri porosinë. Pas pak Poli e hodhi fjalën përsëri te demonstrata e studentëve.

— Një gjë më gëzon ose, më mirë të them, më gëzonte dikur, ahëre kur isha naiv si ti... ti ke filluar të merresh me politikë, në mos gabohem, Zhaklinë?. — këto fjalë i tha me ironi, të cilën nuk u mundua ta fshihte.

— Sikur të thosha po, ti a do ta aprovoje?

— Jo!

— Pse?!

— Ti s'je prerë të merresh me politikë! Ç'të duhet ty politika? Leri të tjerët të thartojnë trutë me të!

— E mora vesh... ti je prerë për politikë dhe kërkon ta bësh monopol. Ti je kokë e rrallë për politikë, apo jo?! — kësaj here fola unë me ironi.

— Këtu gabohesh... Politika më intereson më pak se çdo gjë tjetër! — u përgjegj Poli, që bëri sikur s'e vuri re ironinë në fjalët e mia.

— Që kur kështu?!

— Ka ca... Qysh nga ajo ditë kur pashë që e fejuara ime po fillonte të merrej me politikë!

— Kjo s'më besohet! Ti tallesh ose gënjen! Tani, që e fejuara «po merret me politikë», ti ke më shumë arsye të jetosh me politikën. Ne do të ishëm një çift i zgjedhur politikanësh, do të bënim karrierë! Apo jo?..

— Jo! — tha ai prerë, me një zë ku ndiheshin tingujt e dëshpërimit dhe të inatit.

— Ahere ti ke bërë kthesë, Pol? Kjo do të më habitte!..

— Gjëra që ndodhin! Evolucioni i konflikteve krijon gjithmonë një gjendje të re... Këto janë fjalë të vëllait tënd!..

— Nejse, ta lëmë këtë muhabet.. Ti si u ndodhe këtu, ishe me detyrë? — e pyeta.

— Jo.. rastësisht — tha ai dhe ndezi një cigare tjetër.

— Sikurse unë... Mirë, si u ndodhe pranë meje?

— Të pashë që kur dole nga metroja.

— Pse s'më fole?

— S'munda... Unë kam shumë nevojë të bisedoj me ty, Zhaklinë, po jo këtu!

— Mirë, ikim; po ku të vemi?

— Tek unë; ne kemi një vilë të re tani. Ti s'na ke vizituar. Mbase gjejmë dhe Zherarin atje. Ai do të gëzohet shumë kur të të shohë... — U ngritëm, dolëm nga bufeja, qëndruam një copë herë te porta, duke vështruar grupet e studentëve, që po shpërndareshin në drejtime të ndryshme. Poli buzëqeshi me tallje dhe më tërhoqi nga krahu. Ecëm një copë rrugë në këmbë derisa gjetëm veturën, të cilën Poli e kish vënë në një vend të sigurt. Kish blerë veturë të re. Ndofta nga ky shkak më pëlqeu të ulesha në timon. Poli u ul pranë meje me një indiferentizëm të dukshëm. I mora çelësat dhe e nisa veturën pa ditur se ku duhej të shkonim. S'e dija ku e kish shtëpinë e re Poli, por edhe ai s'po më fliste. Ahere i dhashë karar punës: të dilja në një nga autostradat dhe t'ja shkelja. Unë i kisha nervat akoma të acaruar. Në shpej-

tësi të madhe krijohen përshtypje të tjera për kohën, për sendet e njerëzimit; me një fjalë, sikur harrohet realiteti. Këtë dëshiroja dhe unë për ato caste... Para syve të mi rrëshqisnin vija të panumërta në drejtim nga para-prapa. Në një moment të tillë m'u kujtua skena e një filmi, ku një vajzë, që ngiste veturën, hidhet në lumë bashkë me dashnorin, i cili s'e dashuronte më.

Pas pak Poli më foli. Më tha të ktheheshim nga e majta dhe më dëfteu rrugët për të shkuar në banesën e tij. Unë e ndala veturën, ndeza një cigare, pastaj u nisa me shpejtësi të zakonshme. Pasi kaluam bulevarde e rrugë, dolëm në periferi të qytetit, në një lagje të re. Atje e kish vilën e re im vëlla: zyrat e punës, dhomat e banimit për vete dhe për sekretarin e tij, Polin. Ishte një vilë e vogël, por e bukur, me kopsht dhe garazh për vetura. Në oborr kishte njerëz që hynin dhe delnin me pamje të merakosur ose duke bërë shaka. Poli më çoi në apartamentin e tij, që e kish hyrjen nga prapa. Më la në sallonin e pritjes dhe shkoi të takonte Zherarin. Salloni ishte i vogël, i mobiluar thjesht, me një tavolinë në mes dhe tri karri-ga prej lënde plastike. Një derë të çonte në banjë, tjetra në dhomën e gjumit. Hyra aty me druajtje. Hodha një vështrim hetonjës që nga praku i derës. Batania e shtratit ishte zhubravitur. Një raft i komodinës, në krye të shtratit, kish ngelur i hapur. Edhe dritaren e kish lënë hapur dhe era, që frynte, i kish rrëzuar përdhe nga tavolina e punës disa shkresa dhe një libër. Mua më tërhoqi vëmendjen një letër e bardhë me një rresht të shkruar. Bëra disa hapa drejt saj. U ula, mora letrën dhe e le-

xova: «E dashur Zhaklinë...». Vetëm kaq kishte shkruar. E lashë fijen e letrës ashtu siç e gjeja, pranë bibliotekës së librave. Nga dhoma e gjumit kalohej në kuzhinë. Dera kish ngelur përgjysmë e hapur, por unë ngurroja të hyja atje. Dola përsëri në sallon. U ula në një karrige e po prisja. Dalëngadalë u krodha në mendime. Çka më mundonte më shumë në ato çaste ishte shqetësimi për përçarjen e familjes. Ndodhka që edhe njerëzit e familjes qenka e vështirë t'i njohësh mirë. Mbase kjo vjen nga moshja: vajzat e reja, si unë, s'i vënë re dhe aq shumë njerëzit që kanë para syve çdo ditë ose s'ua vënë veshin mirë fjalëve dhe këshillave të tyre!.. Por kjo s'vazhdoka gjatë. Aq më mirë!.. Për këtë arsye unë u përpoqa t'i sillja para syve tiparet dhe karakteret e tyre me shpresë se mos gjeja burimin e shkaqeve, që kishin çuar në përçarjen e familjes sonë. E nisa me Albanëzin. Ai vinte me trup të lartë, me kurrizin pak të kërrusur, megjithëse në të rëndonin më shumë se shtatëdhjetë vjet. Shumë tërheqëse ishte fytyra e tij: me një sërë rrudhash në ballë, me leshra të zbardhur, por të dendur; dy rrudha të mëdha në faqet, që mbyllnin si në kllapa mustaqet e prera alla Stalin, vetulla të trasha, që u bënë strehë syve të gjallë, të zgjuar, sy që të bënë t'i adhuroje edhe kur inatoseshin. Në fytyrën e Albanëzitet shprehej optimizmi dhe vendosmëria. Fytyrën e rrudhosur të një plaku vetëm optimizmi mund ta bëjë simpatike deri në atë shkallë sa ta pëlqejnë edhe vajzat. Unë e adhuroja Albanëzin, prandaj kisha frikë se mos isha e padrejtë karshi Zherarit. Ky vinte me trup mesatar të mbajtur mirë. Ishte shu-

më i shkathët, megjithatë dinte t'u jepte lëvizjeve të tij një farë elegance delikate. Nga flokët s'i ngjante as të atit as së ëmës. Flokët e tij kishin një ngjyrë të veçantë. Unë s'arrija ta përcaktoja. Sytë i kish kafe, sy të zgjuar. Këta ja bënë fytyrën tërheqëse. Si militant i Partisë Komuniste, Zherari nuk mundohej të imitonte të mëdhenjtë si në zakone ashtu edhe në veshje. Ai kërkonte të ishte origjinal, njeri i kohës, të krijonte personalitetin e tij. Për t'ja arritur qëllimit, përdorte çdo mjet. Për të kishte rëndësi qëllimi dhe jo mjetet. Kështu më dukej mua. Kështu mendonte dhe Albanezi. Zherari ishte njeri i aftë në këtë drejtim: dinte të manovronte me shkathtësi. Nga ana tjetër ai ishte gojtar i zoti, s'e lidhje dot me fjalë...

Ishte e natyrshme që, nga Albanezi dhe Zherari, të kaloja te Luiza. Kësaj i kisha kushtuar kujdes më pak se çdo njeriu tjetër të familjes apo të rrethit tonë. Prandaj dhe s'e njihja mirë. Kisha vënë re se Luiza ishte e bukur, kishte trup të rregullt, por s'dinte të mbahej, s'ishte vajzë e kohës. Veçse ky mendim nuk e pati të gjatë. Në një rast m'u desh të pranoja, dhe më vonë u binda për këtë, se Luiza vërtet që vishej thjesht, por ama vishej me shije. Një herë tjetër e kundrova me vëmendje në kohën që ajo bëhej gati për të shkuar në uzinë dhe vura re diçka që me habiti: Luizës i shkonin për bukuri rrobat e punëtores!.. Ç'është e vërteta, kohët e fundit unë po i ndryshoja mendimet për Luizën. Jo se ajo kish filluar të mbahej më mirë. Ishte një shkak tjetër: idetë e reja që po më hynin në kokë, pas punës së vazhdueshme që bënte Albanezi, krahas tij dhe Izidori, me mua, më bë-

nin që ta shikoja Luizën me një sy tjetër, që ta merrja si shembull për veten time...

Në këtë kohë e sipër erdhi Poli. Hyri në sallon; portën e la hapur. Unë u ngrita dhe e mbylla. Dukej i mërzitur, si i inatosur; duke bërë tute-tëhu, hope-hope në sytë e buzët e tij bridhte një nënqeshje tallëse. Unë s'flisja, i ndiqja me sy lëvizjet e tij, e tronditur. Më së fundi ai u ul në karrigën përballë meje. Më vështroi e buzëqeshi, duke tundur kokën.

— Duhet të presësh! Zherari është shumë i zënë, s'gjen dot një minutë të lirë që të vijë këtu! Unë jam sekretar i tij personal dhe m'u desh të prisja radhën që t'i flisja! A më kupton, Zhaklinë? — tha me një zë, në të cilin ndihej ironia dhe zemërimi.

— Mirë, unë po iki ahëre — i thashë.

— Jo, prit, të lutem!.. Fundja aq më bën për Zherarin! Unë kam hallin tim, si ta them,.. hallin tonë.. Zhaklinë, ti kishe diçka për të më thënë!..

— Unë? Jo, — i thashë, e ndodhur ngushtë.

Qëndruam një copë herë pa folur. Ndezëm nga një cigare. M'u duk e vështirë të hapja gojën në atë ambient të ftohtë e të zymtë. Megjithatë e pashë se ishte më mirë të sqaroheshin marrëdhënjet tona. Tani puna ishte që ta bëja Polin të fliste i pari. I thashë:

— Ti sikur kishte diçka për të më thënë! Pse erdha këtu?..

— Po.. Zhaklinë.. Duhet ta sqarojmë gjendjen tonë!.. Më duket se ti nuk më dashuron më!..

Unë desha të përgjigjesha se kurrë nuk e kisha dashuruar, por ndërrova mendje.

- Jo!.. — fola me gjysmë zëri.
- Pse?!
- Në disa anë, në anët më të këqia, ne i ngjajmë shumë njëri-tjetrit, Pol!
- Po pastaj?!
- Domethënë ti e pranon se ngjajmë me njëri-tjetrin?..
- Kështu më duket edhe mua!.. Po ç'të keqe ka këtu?
- As unë s'e kam të qartë!.. Di vetëm një gjë: kam nevojë për një njeri që të jetë më i mirë se unë.
- Ti më bën të qesh Zhaklinë, — dhe ai qeshi me të madhe.
- Unë qëndroja e qetë, pa e prishur gjakun.
- Fola:
- Unë them ato që ndjej. Për mua s'ka rëndësi në arrijnë të tjerët të më kuptojnë apo jo!..
- Me këtë s'më mbushet mendja! Ndonjë shkak tjetër?
- Tjetër?.. mirë.. Ja, për shembull... Në fillim të fejesës sonë, kur rrija pranë teje, më vinte për të qeshur, kurse tani mërzhitem!..
- Kjo do të thotë se ti je e ftohtë nga natyra!..
- Vetëm me ty...
- Vërtet?! E ke provuar me të tjerë?
- Po... — thashë pak e nxituar.
- Me cilin?
- Me Izidor Romelon...
- Dhe çfarë ke ndjerë, kur të ka puthur ai?!
- Ti do të tallesh, Pol!
- Aspak!. Unë dua të di në e ndjen dashurinë, kur rri me Izidorin.

Unë s'dija ç'të thoshja. U inatosa. U ngrita. S'dija ç'të bëja. Ndeza një cigare. Shkova para pasqyrës. Poli rrinte me kokë ulur, priste. I shkova nga prapa, e zura nga supet me përkëdheli dhe i thashë:

— Pol, më duket se është më mirë ta prishim fejesën tonë!..

— Dakord! — u përgjegj ai me një zë të qetë.

Unë s'e prisja këtë përgjegje kaq shpejt. Ndjeva një rrënqethje në trup.

— Ulu, ulu dhe më dëgjo! — tha.

Unë u ula karshi tij dhe po e shikoja me ngulm.

— Zhaklinë, unë s'po habitem me fjalët e tua, ti e shikon!.. Veçse sot e kuptova që asnjëri s'më do, as Zherari, bile as ti! Mua s'më beson dhe s'më kupton njeri! Tani po e marr vesh se unë nuk kam lindur për të jetuar si njeri. Duket që nuk e ditkam se ç'është jeta dhe, fundja, kështu si rrodhën ngjarjet, as që kam nevojë ta di. Më në fund kuptova një gjë: jam i tepërt në shoqëri, nuk e kam vendin që më takon, unë u zë rrugën të gjithëve. Këtë fat, s'e prisja!..

Më erdhi keq për Polin. I thashë se ne mund të mbeteshim miq...

— S'më duhet miqësia, Zhaklinë, unë kisha nevojë për dashurinë, që të ngushëllohesha! — u përgjegj ai me tonin e zakonshëm.

U ngrita dhe po bëhesha gati të ikja. E përshëndeta. Ai më tha se do të vinte me mua, të më përcillte. Nuk e kundërshtova. Zherarin s'ma zuri më në gojë. Hipëm në veturë dhe, gjatë rrugës, nuk shkëmbyem asnjë fjalë. Ai e ngiste veturën

ngadalë, me kujdes. E ndali para shtëpisë sime. U ndava prej tij, duke i kërkuar falje për shqetësimet që i shkaktova. Poli tundi kokën në shenjë pohimi dhe u nis me shpejtësi të çmendur. Unë hyra në shtëpi e menduar dhe e lodhur...

REVOLTA E IZIDORIT

Kur u ndava nga Pol Tenieni, nuk më shkante ndër mend që rasti do ta binte të takohesha përsëri me të qysh të nesërmen. Puna e kërkonte që ne të rrinim një kohë sa më të gjatë pa u parë. Kështu do të kish qenë më e lehtë si për mua dhe për Polin që të harronim njëri-tjetrin sa më shpejt.

Në mëngjez, aty nga ora tetë, erdhi në dhomë Luiza dhe më tha se dikush më kërkonte në telefon. U ngrita menjëherë, dola në sallon dhe, me zemër në ethe, kapa receptorin e telefonit. Që në fjalën e parë e njoha nga zëri: ishte Izidori. I dërgova një të puthur me anë të telefonit, ndërsa po fluturoja nga gëzimi. Më dukej sikur e kisha Izidorin para syve; nuk dëgjoja fare se ç'më thoshte. Ai u detyrua të përsëriste fjalët që kish thënë një herë. Kërkonte të takohej sa më parë me Zherarin dhe këtë gjë ma ngarkonte mua që ta rregulloja. Nga zëri dukej shumë i tronditur. I thashë se brenda një ore do t'i ktheja përgjegjë. Ai e mbylli telefonin. U mendova një copë herë se ç'duhej të bëja. T'i telefonoja drejt Zherarit, patjetër në telefon do të dilte Poli. Të shkoja ta takoja, e njëjta gjë. Te Zherari duhej të kaloja me anë të Polit. Ja, kështu erdhi rasti që u detyrova të takohesha përsëri me ish-të fejuarin tim.

U Telefonova. Doli Poli. I thashë se Izidor Rome-
loja kërkonte të takohej me Zherarin për një çë-
shtje me rëndësi. Poli u tregua i sjellshëm; më tha
të prisja pak në telefon sa të bisedonte me Zherarin.
Pas një çikë dëgjova zërin e tij të ftohtë: Zherari
mund ta pristte Izidorin në orën pesë të mbasdites.
Unë e falenderova dhe mbylla telefonin.

Aty për aty i telefonova Izidorit. E lamë që në
orën katër të shkoja unë në spital dhe që andej të
dy së bashku të shkonim te Zherari.

Në orën e caktuar isha në sallonin e pritjes të
spitalit. Më thanë se Izidori kishte dalë para pak
kohe. U ula ta prisja. Sapo ndeza një cigare, Izi-
dori u dha te dera. Më buzëqeshi, megjithatë s'mun-
di ta fshihte shqetësimin. U ul pranë meje. Unë
e pyeta. Ai ndezi një cigare, pastaj më tha që
një shok e kishte lajmëruar se Antonelo Martinin,
militantin e shquar komunist, të cilin e njihnin
të gjithë, e kishin përjashtuar nga partia. Në ga-
zetën e partisë, një ditë më parë, ishte shkruar
për këtë çështje, por Izidori s'u kish besuar syve
të tij. Shkaku i përjashtimit ishte formuluar kësh-
tu: Martini përjashtohet nga partia si element anti-
parti. Në gazetë ishte shkruar gjithashtu se celula,
ku bënte pjesë ai, kishte qënë unanimisht dakord
me këtë vendim. Ndërsa e vërteta qëndronte ndry-
she: kundër Martinin kishte kohë që nga udhëheqja
e partisë ishin ngritur një sërë akuzash fallso, një
sërë shpifjesh të ulëta, për ta mposhtur shpirtë-
risht. Kur e panë se me këto s'ja dolën në krye,
kundër tij u përdor makinacioni i thjeshtë: përja-
shtim nga partia si element fraksionist. Në mble-
dhje të celulës, ku bënte pjesë Martini, merrte pje-

së vetëm një e treta e anëtarëve, kurse gazeta shkruante se ai ishte përjashtuar me unanimitet. Kjo ishte një shpifje e tmerrshme, që e kish revoltuar në kulm Izidorin. Ai s'u kish besuar në fillim fjalëve të shokut, që kish prurë lajmin për Martinin, s'u kish besuar syve të tij, kur kish lexuar në gazetë gjëra të trilluara. Izidorit i vinte të hante veten me dhëmbë. Ai kurrë nuk mund të besonte që Antonelo Martini, pjesëmarrës i revolucionit bolshevik në Rusi, luftëtar i Spanjës, komandant i rezistencës kundër gjermanëve gjatë luftës së dytë botërore, militant komunist, që gjithë jetën ja kishte kushtuar çështjes së madhe të klasës punëtore, të ishte «element antiparti»! Këtu luhej një tragjedi me pasoja të rënda jo vetëm për Martinin, por dhe për vetë fatin e partisë...

Unë dëgjoja me gjakftohtësi fjalët e zjarra të Izidorit. Asnjëherë s'e kisha parë në atë gjëndje. Sytë i çonin shkëndija urrejtjeje. Më i dhimbshëm në pamjen e Izidorit ishte dëshpërimi, që i kish zënë fytyrën dhe ai s'dinte si ta shfrente, s'dinte ku të përplaste dufin e zemrës së revoltuar. Sikur ai të vazhdonte qoftë dhe një orë në atë gjëndje, me siguri do të sëmurej. Mendova për disa çaste dhe e pashë që puna më e mirë ishte që në fillim unë të bija dakord me të për çdo gjë... Apropojat çdo fjalë të tijën po edhe e këshilloja të qetësohej. Vetëm kështu ai mund të bënte ndonjë gjë për Martinin. I kujtova se ora po afrohej për të shkuar te Zherari. Mund ta bisedonim këtë çështje me tim vëlla. Izidori sikur erdhi në vete kur i përmenda Zherarin dhe tha se takimin me të e kishte kërkuar për të folur për Martinin... U

ngritëm. E zura nga krahu dhe shtrëngohesha fort pas Izidorit që t'i jepja zemër. Jashtë na priste një veturë. Në timon ishte po ai shok që i kish prurë Izidorit lajmin e hidhur. Hipëm të dy prapa. Tregova se ç'rrugë duhej të ndiqnim dhe numrin e shtëpisë së Zherarit.

Kur pashë që Izidori u qetësua pak i mora dorën, ja vura në prehrin tim dhe po e përkëdhelja lehtas me dashuri. Ai më shikoi me ëmbëlsi për një çast. Më hodhi dorën në sup. Unë ngjeshja kokën në gjoksin e tij, ndërsa lëkundjet e vefurës përkundnin ëndrën time, që po më pushtonte ngadalë mendjen dhe zemrën. Kënaqësinë më të madhe ma jepte fakti që unë ndodhesha pranë Izidorit në çaste të vështira për të. Ky ishte një iluzion i këndshëm, sepse po më jepej rasti për të treguar me prova se sa shumë e doja Izidorin, tamam në kohën kur ai kishte nevojë për mbështetje dhe për inkurajim. Këtë gjë vetëm unë mund ta bëja — të paktën kështu më dukej mua ose dëshiroja të ishte ashtu. Entuziazmi i madh më shtynte nganjëherë deri në mendime sentimentale: po ta lypte nevoja, unë do të bëja çdo sakrificë për Izidorin. Në këto çaste e ndjeva se isha e tëra e Izidorit, si gruaja e tij besnike dhe e devotshme, e lidhur me të jo vetëm fizikisht, por edhe shpirtërisht, e lidhur me të gjitha qëllimet dhe interesat e tij... Izidori tha papritur, me gjysmë zëri, sikur foli me vetë:

— Po, ke të drejtë! Duhet të qetësohem, ndryshe s'kam për të bërë gjë!..

Pas një çike foli shoku në timon:

— Më duket se mbërritëm!..

Unë vështrova nga e djathta. Ndodheshim para shtëpisë së Zherarit. Zbritëm. Shoku i Izidorit çoi veturën disa metra më tutje dhe tha se do të na priste atje. I rashë ziles. Pas pak doli të hapte portën e hekurt të oborrit Poli, me pamjen e tij flegmatike. Ai na udhëhoqi deri në sallonin e pritjes dhe shkoi menjëherë të lajmëronte Zherarin, i cili nuk vonoi të vinte. Im vëlla më hodhi duart në qafë dhe më puthi në faqe, pastaj i dha dorën Izidorit. Zherari ishte në qejf ose bënte sikur ishte. Unë s'arrita ta kuptoja. Më hoqi vrejten që s'kisha shkuar ta shihja për një kohë të gjatë, duke u justifikuar që për shkak të punëve të shumta, s'kish pasur mundësi të vinte në shtëpi tek ne. Kur dëgjova kësisoj, u binda që ai s'dinte gjë për sëmundjen time. Nuk më erdhi mirë... Më pyeti për Albanëzin dhe Luizën. Duke shikuar i qeshur Izidorin, tha si me shaka për të atin:

— Plaku po na nxjerr shumë telashe; është bërë element i rrezikshëm!..

Unë s'folja. M'u duk me vend që të mos flisja. Izidori më vështroi me kuptim. Zherari na ftoi të uleshim në disa kolltuqe luksoze. Çdo gjë aty ashtu ishte: të binte në sy dora e fundit e teknikës së mobilimit, thjeshtësia dhe lehtësia praktike e një salloni zyrtar. Kjo pamje më vrau sytë; s'e ndjeva veten mirë, sikur kisha ftohtë. E vura re që edhe Izidori rrinte si i ndrojtur. Mbase më dukej mua ashtu, se unë fillova vetë të rrija si mbi gjemba.. S'vonoi shumë dhe i rashë në të: bezdia, që ndjeja, më shkaktonte nga prania e Polit, që rrinte pak më tutje Zherarit, si ndonjë statujë prej dëbore.

Izidori foli papandehur:

— Më fal, shoku Zherar, që po të marr ca kohë!.. Unë kam ardhur për të biseduar me ty rreth dy çështjeve me rëndësi..

— Oh, Izidor, çenke i nxituar! — ja pat Zherari dhe i ra supit. — Pol, të lutem, na rregullo ndonjë send për të pirë. Ndërkohë ne po e ndezim nga një — dhe zgjati një paketë cigaresh Ruajal.

Zherari e pyeti me hollësi Izidorin për shëndetin dhe kur në u afruam rreth tavolinës me pije, pasta dhe fruta të ndryshme, ai i tha, si gjithnjë me buzë në gaz:

— Shërohu shpejt, shoku Romelo, partia ka nevojë për njerëz si ti, sidomos në situatën e tanishme!

Vura re se Izidori ishte pak i ngutur, megjithëse mundahej ta përmbante veten, të ruante gjakftohtësinë. Zherari përpiqej të krijonte një ambient të ngrohtë, ambient të përzemërt shoqëror. I tha si me shaka sekretarit të tij:

— Pol, bëhu gati për mbrojtje! Siç po e shoh, shoku Romelo ka ardhur të na sulmojë! — Hodhi një gotë konjak, pastaj iu drejtua Izidorit: — Tani jam gati të të dëgjoj!..

— Shoku Zherar! — tha Izidori dhe mori frymë thellë. — Erdha të bisedoj me ju..

— Me ty! — e ndërpreu Zherari.

— Më fal.. me ty... për çështjen e Antonelo Martinit!..

— Ç'të lidh me të, Izidor, s'e kuptoj? — pyeti Zherari i qetë dhe i qeshur.

— Lufta jonë e përbashkët!..

— Të lidhte dikur, por jo tani!

— Edhe tani! Atë e përjashtuan padrejtësisht nga partia!

— Martini u përjashtua si element antiparti. A e ke të qartë, shoku Romelo? — tha me një ton të prerë Zherari.

— Jo.. Ju harruat se keni të bëni me një militant të vjetër, militant të shquar të Partisë Komuniste!

— Ishte ashtu! Tani s'është! A më kupton!?

— E dyta: kundër shokut Martin është ngritur një akuzë fallse dhe....

— Është shpifur?.. Këtë deshe të thoshje?

— Po, ti ma more nga goja — tha Izidori.

Biseda u ndez menjëherë. Zherari dhe Izidori shkëmbyen për një çast nga një vështrim të rreptë. Por Zherari e kapi aty për aty fillin. Qeshi dhe i ra krahëve kundërshtarit, duke i thënë:

— Vazhdo, vazhdo, Izidor!

— E treta: celula nuk e ka përjashtuar me unanimitet Martinin. S'ishte veçse një e treta e anëtarëve në mbledhje. Kjo është thyerje e disiplinës së partisë!...

— Oh, prapë me këto avaze! — tha Zherari dhe u ngrit. Shkoi dy tre hapa më tutje karshi Izidorit. — Është për t'u çuditur: disa shokëve u është bërë zakon që, kur s'dinë si ta sjellin muhabetin, menjëherë kapen pas disiplinës.. Dëgjo, Izidor, po ta them hapur: unë s'para u besoj atyre që e kanë në majë të gjuhës disiplinën për hiç gjë!...

— Unë kam prova. E vërteta qëndron ndryshe! Gazeta jonë ka dhënë një lajm të rremë, me qëllime të caktuara..

— Je i sigurt për këtë që thua?! A e kupton

se me çfarë përgjegjësie e ngarkon veten kur flet në këtë mënyrë?.. Shiko, se ndofta të kanë gënjer ose padashur po gënjen dhe ti!

— Unë nuk di të gënjej, gënjeshtër është e huaj për mua, kurrë s'i kam gënjer shokët! — zëri i Izidorit u drodh nga inati.

— Po armiqtë e tu a di t'i gënjeshtër?

— Jo! Unë di t'i luftoj ata! Armiqtë nuk luftohen me gënjeshtër! — Unë e pikasa menjëherë hilenë e Zherarit, kurse Izidori jo, se ishte i inatosur. Zherari po e largonte me marifet nga thelbi i bisedës. Ai vazhdoi:

— Keq, Izidor! Në këtë mënyrë nuk mund të luftosh ashtu siç duhet kundër armiqve të klasës punëtore, kundër tyre, duhen përdorur të gjitha mjetet, kur e kërkon puna edhe gënjeshtër!

Izidori s'u përgjegj, e humbi fillin e mendimit. E pashë me vend të ndërhyja për ta ndihmuar. Fola:

— Është fjala për Martinin apo jo, Izidor?

Zherari më shikoi me bisht të syrit. Erdhi dhe u ul aty ku ishte më parë. I vuri dorën në sup të Izidorit dhe e pyeti:

— Si përfundim: ç'kërkon nga unë?

— Të përdorësh autoritetin tënd për të anuluar përjashtimin e shokut Martin nga partia!

— Kjo gjë s'varet nga unë.

— S'më besohet! — tha me një farë qesëndie Izidori.

— Pa dale, more shok, kush të shtyri të vish këtu?!

— Asnjëri! Ke dyshime, shoku Zherar?

— Po.

— Për cilin?

— Për ndonjë përkrahës të Martinit ose... për tim atë, s'do të çuditesha.

— As njëri, as tjetri! Pse vë gishtin mbi shokun Moris? Kjo më habit!..

— Sepse ti s'e njeh atë, unë e njoh mirë! Ti- pa si babai im janë kokëngjeshur.

— Këtë gjë s'e prisja nga ti, shoku Zherar! Ke konsideratë të keqe për babanë tënd, që të ka rri- tur, edukuar;.. je i padrejtë! — tha me zemër të thyer Izidori.

— O, more shok, ti s'di gjë, e ke kollaj të fla- sësh kështu!

— Unë nuk di shumë gjëra, por ato pak gjë- ra që di, më mjaftojnë për të njohur njerëzit!

— Nejse, nejse, të pimë nga pak, në kohën që flasim! Zhaklinë, merr diçka, një portokall! — tha Zherari me fjalë të ngrohta. Izidori sa lagu bu- zët dhe e la gotën në tryezë. Unë mora një por- tokall. Zherari e ktheu gotën me një të ngritur. Ai pinte mjaft dhe e mbante pijen. Vetëm në këtë ves i ngjante të atit. Poli pinte me karar. Izidori më hodhi një vështrim dhe foli:

— Çështja e dytë që dëshiroj të bisedoj me ty, shoku Zherar, është për pikëpamjet e shokëve ki- nezë dhe shqiptarë. Kam kohë që kam dashur të të flas për këtë çështje..

— O, s'ja vlen barra qiranë! Me gjithë mend e them! S'e kuptoj përse disa njerëz skandalizo- hen për një grusht dogmatikësh! Lerjani popujve të këtyre vendeve ta zgjidhin këtë problem!

— Më duket se s'ke të drejtë, shoku Zherar! Ne jemi komunistë, jemi pra, dhe internacionalistë.

Një problem që shqetëson aq shumë komunistët kinezë e shqiptarë, na përket edhe neve!.. — tha Izidori me vendosmëri.

— Nejse, nejse, hajde shkojmë atje, të rrimë rehat! E marr me mend se këtu do të zgjatemi. Kam parasysh këmbënguljen tënde, Izidor; ti sikur i ngjan tim ati në këtë anë!..

U ngritëm të gjithë dhe shkuam e u ulëm në disa kolltuqe të gjëra e të rehatshme në fund të sallonit, të vëna qëllimisht për biseda të gjata. Në këto çaste unë thashë me vete: «Përse Zherari tregon aq durim me Izidorin dhe humbet aq kohë, ndërsa pak më parë tha se s'gjente dot një orë të lirë për të ardhur tek ne në shtëpi?!» Vetëm kur pyeta Izidorin, para se të kthehesha në shtëpi, e mora vesh se si qëndronte puna...

Zherari tregonte kujdes të veçantë dhe e shtynte Izidorin të pinte, duke hedhur ndonjë fjalë për të qeshur. Njëherë vura re që Zherari i shke-li synë Polit dhe i bëri me shënjë për shishen me konjak. Ky gjest më bëri të dyshoja. Në çastin që Izidori, i shtyrë nga Zherari, ngrii përsëri gotën, unë i shkela këmbën. Ai më shikoi me marifet dhe bëri shenjë se më kuptoi.

Ambienti i dyshimtë që po krijohej nuk më pëlqeu hiç. Unë e humba në fillim, pastaj e ndjeva veten të shqetësuar, kur pashë që diç po kurdisej kundër Izidorit. Kjo gjë më bëri që ta shikoja me një sy vigjilent si Zherarin ashtu dhe Polin. Por unë s'e kuptova se ku qëndronte shkaku që i shtynte ata të kurdisnin ndonjë poshtërsi kundër Izidorit. Mbase unë e tepëroja me dyshimet e mia dhe në atë mes mund të mos kishte asnjë rrezik

për Izidorin. Ndofta dashuria për të më shtynte t'i shikoja me xhelozë dhe me frikë gjestet e të tjerëve, të cilët ishin njerëz të afërt për mua, por jo të dashur dhe të devotshëm si Izidori.

I pari foli ky; pas një ndërprerje të shkurtër të muhabetit, tha:

— Shoku Zherar, pse u fshihet anëtarëve të partisë sonë qëndrimi i vërtetë i Partisë së Punës të Shqipërisë?. Pse s'botohen dokumentat e saj sikurse ato të sovjetikëve?.. Më duket se është e padrejtë dhe jo komuniste të mbash qëndrim të njëanshëm, duke dëgjuar argumentat e njëres palë, kurse palës tjetër, e cila akuzohet, t'i mohosh të drejtën që të paraqesë mendimet e saj!.. Parime të tilla që i madhi duhet dëgjuar, i vogli jo, i madhi ka të drejtë, ndërsa i vogli ka gjithmonë gabim, nuk janë parime komuniste, internacionale!.. Ja, kjo është pyetja e parë...

— Si duket, paske shumë të këtilla! — tha me ironi Zherari.

— Po!..

— Mirë, mirë, edhe unë jam gati t'u përgjigjem, kam kohë.. Do të të pyes, shoku Romelo: që kur ke filluar të vësh në dyshim qëndrimin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik?

— Unë nuk dyshoj, unë pyes, kam nevojë të sqarohem.. — tha Izidori.

— Përse?!..

— Për sulmet karshi një partie motër!..

— Për kritikën karshi udhëheqjes shqiptare, deshe të thoshje?

— Unë mund të shtoj akoma: për shpifjet karshi një partie komuniste!

— Më duket mua, shoku Romelo, të më falësh se ti ngatërron dy nocione: kritikën me shpifjen!

— Ju do të kishit arësye të më akuzoni si njeri me mendje të ngushtë, që s'dallon kritikën e rreptë nga shpifja, sikur të kishit botuar dokumentat e shqiptarëve, që ne të njihnim se si qëndronte e vërteta në konfliktin sovjeta-shqiptar...

— Ç'janë këto «shpifje»? — tha pak i nxehur Zherari dhe aty për aty sikur u pendua, mbase jo që u inatos, por që hyri në kanalën e fjalëve të kundërshtarit. — Nejtë... — tha pastaj, duke i bërë shenjë me dorë Izidorit që të vazhdonte.

— Ne kemi përsëritur në mënyrë shabllone ato që ka thënë Hrushovi dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë... Unë po numëroj disa nga ato që më kujtohen: udhëheqja shqiptare akuzohet si «aventuriere dhe luftënxitëse», akuzohet për «afrim me imperializmin dhe që është shitur tek ai për 30 aspra», për «antisovjetizëm», që «shqiptarët janë gjak-nxehtë», që «ata kërkojnë të rrëmbejnë flamurin e antirevizionizmit», që «në Shqipëri mbretëron regjimi i terrorit», shqiptarët akuzohen si stalinistë e të tjera e të tjera. Deri dje ne thoshim se Enver Hoxha ishte një ndër marksistë-leninistët e shquar; sot, me një të kollitur, ai na u shndërrua në një terrorist!.. E shumë gjëra të tjera, kush i mban mend të gjitha!..

Zherari qëndroi disa çaste pa folur, me sy përdhe, duke thithur cigaren. Mbushi gotën e tij me konjak dhe e ktheu. Shikoi me një buzëqeshje pak si tallëse Izidorin, i hodhi një vështrim me kuptim Polit, që dëgjonte në heshtje, pastaj tha:

— Tani e mora vesh: të paskan fryrë mirë

para se të vish këtu!.. Vetëm pse të respektoj, po pranoj të vazhdojmë diskutimin.. Më vjen keq, paske shumë paqartësira në kokë!. Duhet të hapësh sytë, Izidor, se ke hyrë në një rrugë të rrezikshme!..

— Shoku Zherar, ti harron se unë kam personalitetin tim dhe asnjëri s'lejoj të më shtyjë në ndonjë makinacion të ulët!..

— Mirë, mirë, do të të dëgjojmë ç'do të na thuash akoma! — tha Zherari.

— I marrim çështjet me radhë?

— Dakord.. Po të dëgjoj!..

— A e pranoni si të padrejtë dhe të dëmshëm faktin se sovjetikët ishin të parët që zbuluan publikisht mosmarrëveshjet midis tyre e shqiptarëve?

— Shokët sovjetikë vepruan ashtu siç duhej të vepronin!..

— Pse?! Këto janë veprime të gabuara!. Kështu më duket mua.. Pastaj, ato u bënë në mënyrë të njëanshme, në kongresin e një partie dhe jo në ndonjë mbledhje ndërkombëtare të komunistëve!..

— Vazhdo, vazhdo! — tha Zherari me një ton të qetë.

— Vendimet e një partie s'janë të detyrueshme për partitë e tjera!

— Vendimet e partisë së Leninit kanë qenë, janë dhe do të jenë ligje për të gjithë komunistët e vërtetë!..

— Kjo do të thotë të abuzosh me parimet leniniste, shoku Zherar! Shqiptarët, të paktën, duhet t'i kishin ftuar në kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që të thoshin fjalën e tyre!

— Kjo është çështje e shokëve sovjetikë. Ne s'mund të ndërhyjmë.

— Ne s'kemi të drejtë të ndërhyjmë gjithashtu në çështjet që u takojnë shokëve shqiptarë...

— Ashtu është!..

— Ahere pse i akuzojmë ata për «antisovjetizëm»? Shqiptarët nuk e mohojnë ndihmën sovjetike si gjatë luftës ashtu dhe për ndërtimin e socializmit në vendin e tyre.

— Këtë s'mund ta bëjnë tani për tani... S'janë kaq budallenj! Por s'qëndron këtu çështja!..

— Diçka tjetër: the në fillim se «s'ja vlen barra qiranë të merremi me një grusht dogmatikësh»!.. Pse ahere Hrushovi është i shqetësuar dhe i akuzon ata, dhe, nëpërmjet tyre, shokët kinezë, se me veprimet e tyre «prishin unitetin, përçajnë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare»?!

— Se ata bëjnë lojën e imperialistëve!..

— Shqiptarët thonë të kundërtën.

— Çdo gjë mund të presësh nga ata!

— Ti harron pozitën e tyre të vështirë!.. Kundër Shqipërisë organizohen komplete të tmerrshme me pjesëmarrjen e Jugosllavisë, Greqisë dhe të flotës VI amerikane. Dhe për këtë gjë s'thuhet asnjë fjalë në shtypin e vendeve socialiste. Vetëm gazeta «Puna» e Bullgarisë dha një lajm të thatë. Por e pësuan keq presidenti dhe dy sekretarë të Këshillit Qendror të Sindikatave bullgare. Ata i shkarkuan nga funksionet se protestuan jugosllavët. Këtu luhet një komplot i ndyrë kundër Shqipërisë.

— Procesi i Tiranës ishte një farsë e kurdisur me qëllime propagande.

— Po prerja e ndihmës ekonomike, dëbimi i studentëve shqiptarë nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste të Europës, edhe kjo qenka farsë e kurdisur për qëllime propagande?! Jo, shoku Zherar, këtu luhet me jetën e një populli, të një vendi socialist!.. Hrushovi i dënon udhëheqësit shqiptarë dhe në të njëjtën kohë mundohet të tregojë miqësi për popullin shqiptar!.. Ky është një veprim demagogjik.

— Kjo është shumë e thjeshtë: populli shqiptar duhet t'i bëjë udhëheqësit e tij të kuptojnë se janë në rrugë të gabuar!

— Prandaj i bëhet ky presion?.. — tha me ironi Izidori.

Zherari bëri me dorë duke dashur të thoshte: «Me ty e kam vështirë të merrem vesh!».

— A e di, shoku Zherar, se shqiptarët janë betuar të rrojnë me bar dhe para armiqve të mos gjunjëzohen!.. Ç'popull i mrekullueshëm!..

— Shqiptarët janë romantikë. Kështu ndodh me çdo popull që hyn në rrugën e progresit: në fillim ai është poet, më vonë, kur arrin në kulmin e shkëlqimit të tij, kthehet në mendimtar!..

— Unë mendoj se një popull që hyn në rrugën e socializmit, është njëkohësisht poet e mendimtar.. Sidoqoftë, ti ke mendimin tënd... Tani kam dhe një pyetje të fundit, se ju mbajta gjatë: problemin e paqes dhe të rrugëve të kalimit në socializëm.. Më duket se ata kanë të drejtë kur thonë se nuk duhet absolutizuar rruga e kalimit paqësor, se klasa punëtore dhe partia e saj duhet të jenë të përgatitura për të dy mundësitë: për rrugën paqësore dhe jopaqësore...

— Që të mos zgjatemi, Izidor, ja se si qëndron kjo çështje: ne luftojmë për një politikë të vërtetë të paqes dhe për reforma ekonomike e sociale gjithmonë e më të thella. Në këtë mënyrë klasa punëtore do të mundë të realizojë unitetin e saj e të grumbullojë rreth vetes të gjitha shtresat antimonopoliste, me një fjalë, do të izolojë borgjezinë e madhe dhe do të krijojë kushtet që të kuptojë masa e gjerë e popullit objektivat e revolucionit socialist dhe nevojën për të luftuar për arritjen e tyre... Kështu mendojmë ne për konditat konkrete të vendit tonë... A je i qartë?.. Ke ndonjë pyetje tjetër?

— Jo. Tani më falni, mund të largohem!

— Prit! Ëshë radha ime që të pyes.. Ti harrove një çështje me rëndësi, atë të Stalinit. Ti mund ta dish që udhëheqësit shqiptarë janë kundër kritikës së kultit të individit, sepse në parti të tyre lulëzojnë metodat e kultit të individit.

— Ç'është e vërteta, këtë çështje s'e kam të qartë, më duhen akoma fakte, duhet ta studjoj akoma me vëmendje. Mund të them këtë gjë: shqiptarët thonë se meritat e Stalinit janë më të mëdha se gabimet e tij; këtu ata kanë të drejtë, se në vlerësimet e Hrushovit lidhur me Stalinin ka mospërputhje: ai një herë thotë se Stalinit i «mungonte respekti karshi kujtimit të Leninit», herën tjetër thotë «dhëntë zoti që çdo komunist të dijë të luftojë sikurse ka luftuar Stalini»!. Pastaj për epokën e Stalinit është dhënë një tablo e tmerrshme, që të deziluzion!..

— Izidor, ti e di se si e ka vlerësuar partia jonë periudhën e Stalinit: «një largim i thjeshtë

nga parimet». Ne, komunistët, e ndjejmë veten përgjegjës për këtë periudhë, mbasi ne pranojmë përgjegjësinë për të ardhmen, për revolucionin socialist në shkallë botërore...

— Kjo e ardhme më duket e errët për vendin tonë. Qysh nga viti 1956 në radhët e Partisë sonë është përhapur konfuzioni; do të na duhen shumë vjet për të marrë veten. Dikur ishte ndryshe: komunisti kishte mundësi të tregonte se sa i devotshëm ishte për çeshtjen e klasës punëtore, sepse e kishte të qartë perspektivën. Kurse tani s'di kujt t'i besosh, nuk kupton shpeshherë se ç'ndodh në radhët e partisë, nuk di pse shkon në aksion!. Ja, kjo është e tmerrshme për komunistin, humbja e perspektivës!...

— Ti ke rënë në pesimizëm, Izidor, po e them me keqardhje; ti ke konfuzion në kokën tënde dhe e përgjithëson. Kështu s'është mirë për ty! Nga fjalët e fundit që the, unë nxjerr këtë konkluzion: e di që ti je njeri energjik, njeri i aksionit, nuk mund të rrish pa vepruar.. Por, Izidor, partia komuniste është krijuar për të realizuar idealet e klasës punëtore dhe jo që t'u japë rast për heroizëm anëtarëve të saj... Këtë gjë mos e harro!. Megjithatë unë besoj se kur të fillosh jetën normale, pasi të dalësh nga spitali, do të rifitosh armën e nevojshme për çdo komunist: optimizmin.

— Edhe unë shpresoj se do ta gjej rrugën time!

— Rruga jote është rruga e partisë!

— Të shohim!.. Tani mund të largohem?

— Kështu mendoj dhe unë. Biseduam goxha dhe kjo s'do të jetë hera e fundit, besoj!..

U ngritëm, u përshëndetëm me Zherarin, i cili

na përcolli deri në fund të shkallëve të zyrës. Prisja që ai të më jepte të fala për të atin dhe Luizën. Por Zherari as që u kujtua për këtë gjë, megjithëse e kuptoi dëshirën time. Më erdhi shumë keq. Poli na përcolli deri te porta e hekurt e oborrit. Ai u tregua përsëri i sjellshëm dhe na propozoi që të na conte me veturë deri në shtëpi. E falenderuam dhe i thamë se s'ishte nevoja. Poli na përshëndeti me ftohtësinë e tij të zakonshme dhe mbylli portën. Shkuam në veturën që na priste disa metra më tutje. Shoku i Izidorit, pa thënë asnjë fjalë, na buzëqeshi dhe e nisi veturën sapo mbyllëm dyert. Unë prita pak sa muarëm veten dhe e pyeta Izidorin:

— A ngele i kënaqur nga pritja e Zherarit?

— Po.

— Dhe nga biseda?

— Jo!

— Nuk kuptova një gjë: ti ishe shumë i revoltuar për çështjen e Martinit dhe për çudi s'ngule këmbë në kërkesën tënde... Pse?!

— Ishte e kotë.

— Pse kërrove takim me Zherarin, ahere?

— Për të bindur veten... A ishte e vërtetë që Zherari ishte bërë revizionist dhe se tek ai nuk mund të varja më asnjë shpresë? Këtë gjë e vërtetova... A nuk e vure re se si u bënte bisht pyetjeve të mia?... Unë me qëllim s'ngulja këmbë, se e kuptova qysh në fillim që ishte e kotë të mbështetesh tek ai si më parë... Albanezi yt ka të drejtë.

— Zherari tregoi durim me ty sepse të vlerëson?

— Sepse ka interesa që e lidhin me mua. Unë kam disa vjet që punoj me studentët dhe njoh shumë studentë komunistë.

Unë s'e ngacmova më tej dhe as që e kundërshtova kur më tha se do të më çontë mua më parë në shtëpi, pastaj do të kthehej vetë në spital. Vetura u ndal para bufesë. I dhashë dorën shokut të Izidorit, dhe pastaj këtij. Izidori mbylli dhe hapi sytë me një nënqeshje të lehtë, duke thënë vetëm një fjalë: mirë u pafshim. Unë ngurova për një çast; pastaj, me një lëvizje të shpejtë, e puti në buzë dhe zbrita nga vetura. Ndaloja në hyrje të bufesë dhe pritë sa u nis vetura; përshëndeta me dorë. Në këtë kohë dikush më zuri nga krahu; u ktheva dhe i buzëqesha Albanëzit. Me të u ngjita në dhomë dhe biseduam një copë herë derisa hëngrëm darkën.

SHOKËT E VËRTETË.

Dy ditë më vonë gjeta një shkak për t'i telefonuar Izidorit. I thashë se Albanëzi kërkonte të bisedonte me të lidhur me grevën e punëtorëve të gazit e të elektrikut, që do të bëhej të nesërmen. Ç'është e vërteta, Albanëzi nuk e kishte kërkuar këtë takim. Unë e nxita që ta thërriste Izidorin, duke i thënë se këtij i shkonte fjala në rrethet e studentëve dhe mund ta ndihmonte me ndonjë mënyrë për problemin që kishin në rend të ditës. Albanëzi pranoi, më tepër për të mos më prishur qejfin mua. E kënaqur, i fola përsëri për qëndrimin e mirë që kishte mbajtur Izidori gjatë takimit.

mit me Zherarin. Nga entuziazmi shtova se Izidori do të kalonte patjetër në anën e Albanezitet. E gjithë puna këtu ishte që Izidori të vinte tek ne, në shtëpinë tonë, një orë e më parë dhe që Albanezi të mos mbetej i pakënaqur nga kërkesa ime. Unë jau arrita të dy qëllimeve.

Pasdreke u mblodhën shumë shokë në shtëpinë tonë. Të shumtët ishin punëtorë të rinj dhe entuziaztë. Mbledhjen e bënë, si zakonisht, në sallonin e katit të dytë. Atje diskutuan dhe përpiqan programin e veprimat për ditën e nesërme. Unë zbrisja herë pas here në bufe për të parë se mos kishte ardhur Izidori. Ai erdhi në kohën që sapo kishte mbaruar mbledhja dhe shokët ishin shpërndarë. Në sallon kishin mbetur Albanezi, Bernar Maiku dhe Luiza, që bisedonin akoma për grevën e punëtorëve të gazit e të elektrikut. E pritën Izidorin me ngrohtësi. Kjo gjë më gëzoi dhe shpërblim unë e putha Albanezin në faqe. U ulëm rreth një tavoline dhe, duke pirë çaj, nisi biseda. Albanezi i tha Izidorit që t'u fliste mbi gjendjen në lëvizjen e studentëve. Ai pranoi me kënaqësi dhe hyri drejt e në temë:

— Gjendja paraqitet pak a shumë kështu (po jua tregoj në vija të përgjithshme): Lëvizja e studentëve komunistë ka hyrë në rrugën e kaosit nga pikëpamja organizative e ideologjike, është bërë një llum që s'e merr vesh i pari të dytin!.. Janë shfaqur një mori rrymash politike; vrehet, bile, tendenca për të qenë plotësisht të shkëputur nga partia. Nga ana tjetër, udhëheqja e partisë kundërvepron me të gjitha mjetet, me metoda shumë të rafinuara, se ndryshe s'di nga t'ja mbajë... Në

fakt disa mbledhje me rëndësi dhe asamble thirren dhe zhvillohen si forume thjesht informative, si mitingje politike, pa u bërë zgjedhje të rregullta të delegatëve. Statuti po shkelet me të dyja këmbët. Diskutimi politik në të shumtën e rasteve është **krejtësisht formal**; puna është që të mbushet salla. Kujdesi kryesor përqëndrohet në mbledhjen e votave; vendimet janë të parapregatitura. Në këtë mënyrë kristalizohen opozitat, tendencat e ndryshme, copëtohet Lëvizja... Dhe e keqja është se në këto mbledhje merren vendime të rëndësishme politike... Tendenca më e fuqishme është ajo që lufton për liri të pakufizuar të fjalës në mbledhje, për të shkruar në shtyp sipas qejfit, kërkon të drejtën për të ngritur «rrethe» diskutimesh, ku mund të flitet hapur dhe të kritikohet vija e partisë dhe politika e saj, për çdo gjë që do t'u vijë për mbarë... Këto gjëra diskutohen midis studentëve. Por, si t'ju them, akoma nuk kanë marrë formën legale ose s'janë bërë tendenca zyrtare. Lufta e brendshme zhvillohet nën rrogosin e unitetit. Të gjitha rrymat luftojnë tezat e njëra-tjetrës dhe as që e çajnë kokën për problemet e detyrat konkrete që preokupojnë Lëvizjen.. Shkurt: gjendja s'është e mirë dhe do të ketë pasoja të rënda me këtë rrugë që ka marrë... Çdo ditë studentë komunistë, duke parë këtë kaos, bien në dëshpërim e nihilizëm dhe dalin nga organizata...

— Po, po, gjendja po bëhet serioze! — tha Albanezi i menduar.

— Unë them, shoku Moris, se qysh tani ajo është katastrofike! — ja pat Izidori.

— Jo tepërime në vlerësimin e situatës, dja-

lë i mirë, shikoji punët me gjakftohtësi e objektivizëm! — e këshilloi Albanezi... Kështu u ndez një polemikë e shkurtër midis plakut dhe Izidorit. I pari pyeti:

— Me sa më ka thënë Zhaklina, ti je caktuar nga partia të punosh me studentët.

— Ashtu është...

— Në më lejon të pyes, në ç'tendencë bën pjesë?

— Me asnjërën...

— Ke vendosur të jesh asnjans?

— Jo!

— Ç'ke ndër mend të bësh, ahëre?

— Nuk e di!..

— Kështu s'është mirë!

— Ka dhe më keq!.. Disa shokë të mi mendojnë se detyra e tyre në këtë situatë të paqartë është të qëndrojnë jashtë kaosit, si të them: përtej së mirës dhe së keqes, të presin derisa e keqja t'i lërë vendin së mirës në gjirin e lëvizjes së studentëve...

— Oh, kjo është qesharake!. Në do që të zhduket e keqja për t'i lënë vendin së mirës, nuk duhet të rrih me duar kryq, duke pritur që kjo të bjerë nga qielli, por duhet të luftosh kundër së keqes me të gjitha forcat. Duke u larguar nga e keqja, siç mendokan disa shokë, në të vërtetë ata vazhdojnë të mbrojnë ekzistencën e saj... A më kupton?

— Po, — u përgjegj i menduar Izidori.

— Dija diçka mbi gjendjen në Lëvizjen e studentëve — tha pas pak Albanezi. — Ti je më mirë në korrent të ngjarjeve për këtë çështje.. Në parti situata është serioze. Udhëheqja e partisë po

shket çdo ditë drejt revizionizmit... Mirë, Izidor, në ç'pikë je i pakënaqur më shumë ti karshi udhëheqjes së partisë?

— Në metodat e ulëta që përdor për të përjashtuar militantët. Unë i dënoj këto veprime!.. Para disa ditëve përjashtuan nga partia Antonelo Martinin, besoj se e dini — tha Izidori dhe u duk i indinjuar.

Albanezi qeshi. Bernar Maiku, që s'kish nxjerrë një fjalë deri atëhere, u hodh e tha:

— Dhe para një dite, Izidor, përjashtuan Albanezin tonë me të njëjtin motivacion sikurse Martinin!

— Vërtet?!.. Atëhere ata paskan një plan në këtë drejtim.

— Kjo është e qartë: çdo komunist, që nuk shkon pas qerres së tyre, përjashtohet pa ceremoni, — u përgjegj Bernari.

— Kjo është e tmerrshme!.. Nesër pra mund të vijë radha ime. Sidomos tani pas takimit me Zherarin!

— S'është çudi. Tani sytë po na shohin gjëra interesante, përjashtime nga njëra anë, largime në masë nga partia të komunistëve të zhgënjyer nga ana tjetër!

— Po, këtë e di!..

— Dhe do të jetojmë ngjarje akoma më interesante! — ndërhyri Albanezi.

Izidori u mendua një copë herë të vogël sa pati kohë të ndizte një cigare. Pastaj iu drejtua plakut:

— Cili është qëllimi juaj, shoku Moris, në mund të ma thoni: të veproni në gjirin e partisë,

sidomos tani që jeni i përjashtuar, e keni të vështirë; mbase do ta keni më lehtë të krijoni grup më vete dhe më vonë një parti të re komuniste, apo jo?

— Qëllimi ynë është të mbrojmë marksizëm-leninizmin! Kjo është detyra jonë e ngutshme. Për çështjen e organizimit me të parë, me të bërë; vetë jeta do të na mësojë, vetë lufta do të na drejtojë...

— Po ti, shoku Izidor, ç'ke menduar të bësh, çfarë rruge do të zgjedhësh?

— Nuk e kam të lehtë të gjej rrugën time!
— u përgjegj ai dhe ra në mendime...

— Pse?

— Kam ende paqartësira në kokë!.. — Izidori mbështeti kokën mbi pëllëmbë të duarve dhe qëndroi disa çaste ashtu.

— Xha Moris! — foli ai papritur — Unë jam duke kaluar një krizë, prandaj kam nevojë të ndodhem pranë teje, të këshillohem me ty.

Albanezi na hodhi nga një vështrim të shpejtë të treve dhe, duke i vënë dorën në sup Izidorit, tha:

— Ne do të të ndihmojmë me sa të mundemi, për këtë të jesh i sigurt. Tani na thuaj: ç'janë këto paqartësira, që ta paskan bërë kokën tym?

— Ja, për shembull, për çështjen e Stalinit!
— foli Izidori duke vënë buzën në gaz si i zënë në faj — Unë kam një dobësi të theksuar karshi tij... Kur dëgjoj për terrorin, për persekutimin e njerëzve të pafajshëm në epokën staliniane, figura e tij errësohet para syve të mi. Atëhere e dënoj atë!... Kur kujtoj Stalinin në krye të Bash-

kimit Sovjetik, vendit që ndërtoi i pari socializmin në botë, që mundi Hitlerin, figura e Stalinit më duket madhështore, e adhureshme. Zati unë kam pasur gjithmonë një dobësi karshi njerëzve të mëdhenj, i kam shikuar nga kënde subjektive.

— Ti i shikon çështjet shumë shtrembër, Izidor! Nuk e di nga të vjen kjo, por mund të them se është e rrezikshme për ty!. — tha Albanezi.

— E di!...

— Në përcaktimin e figurës së Stalinit ti mbështetesh shumë në shpifjet e Hrushovit!..

— Mundet, por unë e admiroj Stalinin!

— Në të njëjtën kohë e dënon?

— Po... e dënoj dhe e admiroj.

— S'ke të drejtë; ti duhet të veprosh ndryshe!

— Si?

— Vlerësoje drejt, në mënyrë objektive tjetrin, pastaj admiroje ose dënoj, zgjidh njerën ose tjetrën! Njeriun që admiron, mund ta kritikosh, por jo ta dënosh! Le pastaj që kur vjen puna për një figurë si ajo e Stalinit, këtu hesapet duhen bërë ndryshe!. Emri i Stalinit dhe vepra e tij janë lidhur me një çështje të madhe të popujve sovjetikë dhe të botës, me socializmin, me kauzën e klasës punëtore. Pra, këtu nuk është fjala thjesht për figurën e një personaliteti. Hrushovi dhe ata që e pasojnë, duke goditur Stalinin, rrahin shumë larg: goditin fitoret e socializmit në Bashkimin Sovjetik, i venë mina me shpërthim të vonuar çështjes së socializmit në botë, goditin marksizëm-leninizmin. Sot Hrushovi u hodh në sulm kundër Stalinit për të pregatitur terrenin për nesër: të sulmojë Leninin, e me radhë deri te Marksi, t'i nxjerrë ata të vje-

truar, të demoduar. Pra, siç e shikon, qëndrimi karshi Stalinit ka të bëjë me qëndrimin karshi marksizëm-leninizmit. Kush mundohet të përlyejë e të poshtërojë emrin dhe veprën e Stalinit, s'është gjë tjetër, veçse një revizionist, armik i marksizëm-leninizmit! Për këtë çështje s'duhet të kemi asnjë iluzion ose tundim në ndërgjegje.

— U pa puna... Meqë e fillova, do ta çoj deri në fund!.. Do t'i them të gjitha. Karshi jush nuk mbaj rezerva — tha Izidori dhe mori frymë thellë. — Unë, xha Moris, sikurse të gjithë njerëzit, apo si shumë njerëz, ndodhem në situata të ndryshme mendore, ose, si ta them më mirë, më saktë... kaloj nëpër tri gjendje shpirtërore: në entuziazëm, në gjendje qetësie dhe në dëshpërim.. Në gjendjen entuziaste çdo gjë e shikoj me optimizëm, e shikoj të ndritur, të mundshme. bëhem revolucionar i flakët, s'kam as më të voglin dyshim për të gjitha parimet e socializmit shkencor, bile, ju siguroj, se shpesh kthehem në një revolucionar ekstremist, jam gati t'i vë zjarrin botës së vjetër me dorën time; nuk marr parasysh asgjë, asnjë interes tjetër para revolucionit proletar dhe kënaqësia ime ëndërrimtare është që të ndodhem në radhët e para të revolucionarëve, që marshojnë me pushkë në duar, duke kënduar Internacionalen... Në çastet e entuziazmit formoj bindjen më të thellë e më të përsosur se revolucionit proletar, vetëm ai, do të nxjerrë artistët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, figura artistike më të mëdha se ato të klasikëve të Greqisë dhe të Romës së lashtë. Shkurt: burimin më të fuqishëm të frymëzimit për realizmin e ëndërrave të mia

krijuese unë e gjej te revolucioni socialist...

— Kjo, në disa drejtime, është një gjë e mirë, — ndërhyri Bernari. — Kryesorja në këtë mes është se ti e kupton rëndësinë e optimizmit revolucionar!..

— Ashtu është!.. — tha Izidori — Por, ... prit!.. Vetëm në çastet e entuziazmit unë jam gati të bëhem hero me ndërgjegje të plotë.

— Dhe je gati të përmbysësh borgjezinë me forcën e armëve? — shtoi Albanezi.

— Pa asnjë lëkundje! — u përgjegj Izidori.

— Po kur entuziazmi të lë shëndenë, atëhere e shikon pushkën me frikë? — e pyeti Bernari.

— Jo... Porse më lindin disa dyshime për rrugët e kalimit në socializëm. Mendoj gjakun që do të derdhet; kjo më bën të lëkundem — tha Izidori.

— Tamam si socialistët tanë! — ja pat me ironi Bernari.

— Ti po ngutesh, Bernar! — i hoqi vërejtjen Izidori.

— Më fal, s'e thashë me qëllim të keq!

— Mirë, u muarëm vesh; kalojmë më tutje!

— Izidori u ngrit; një copë herë bëri nëpër sallon ecë e jakë i kredhur në mendime, duke thithur cigaren me të gjitha forcat e mushkërive. Më së fundi qëndroi karshi Bernarit dhe, me një lëkundje të shkurtër të kokës dhe të duarve, si një lëkundje ankthi, para se të hapte gojën, e shfreu dufin e zemrës. Pastaj vazhdoi:

— Duhet të dish një gjë, Bernar: procesi i formimit të ndërgjegjes revolucionare tek unë kryhet me vështirësi shumë më të mëdha se sa

tek ti, që je punëtor. Ky proces është i lidhur me një sërë faktorësh të jashtëm dhe të brendshëm. Ti e njeh jetën në vendin tonë: sa e gjithanshme dhe në të njëjtën kohë tepër e rrezikshme është ajo për komunistët, nga çdo pikëpamje që ta marrësh! Në këto kushte është e vështirë të krijosh personalitetin tënd nga njëra anë dhe të kesh bindje të qarta, të palëkundshme, nga ana tjetër. Ju thashë një herë se në entuziazëm çdo gjë shkon për bukuri. E keqja më e madhe më vjen në gjëndjen e dëshpërimit dhe mua më takon shpesh të dëshpërohem, sidomos këto kohët e fundit. Krymbi i dyshimit më gërryen për çdo mendim që ka të bëjë me personalitetin tim dhe me bindjet e mia filozofike... E di se dëshpërimi është sëmundje e përgjithshme në vëndin tonë. Dëshpërimi lind zakonisht nga mërzitja; e di gjithashtu, që edhe unë, edhe ne, komunistët, në përgjithësi, nuk mund të dalim pa u lagur nga lumi i dëshpërimit, se ne jetojmë në shoqërinë e kalbur borgjeze.. Po ju tregoj një shëmbull të freskët... S'ka shumë kohë që lexova «Doktor Zhivagon» e Pastërnakut. Atë ditë që mbarova romanin, pata përshypjen që atje gjithshka ishte zmadhuar dhe nxirë në mënyrë tendencioze. Pas ca ditësh takova një mikun tim, komunist dhe ky. Ai kish lexuar «Doktor Zhivagon». Ishte tmerruar nga ato që kish lexuar, kish humbur fare besimin te revolucioni dhe, në kulmin e dëshpërimit, kish dorëzuar taserën e partisë. Ky rast më shtyri ta lexoj dhe një herë romanin. Shkrimtari të bën të besosh si të vërteta të gjitha të «zezat» që shkaktoi gjoja revolucioni bolshevik i tetorit... Kjo është e tmerrshme!... Sa

më shumë që gërmoja në përmbajtjen e romanit, aq më thellë futesha në pusin e dëshpërimit. Dhe m'u desh shumë kohë, shumë përpjekje për të dalë nga kjo gjendje e rëndë. Atëhere fillova të arësyejoj në një mënyrë tjetër: në entuziazëm e në dëshpërim njeriu nuk gjykon drejt, se niset nga pasionet. Vetëm në gjendjen e qetësisë së plotë nervore mund të gjykojë në mënyrë objektive. Duke vepruar kështu, hyj në fushën e arësytiveve. Këtu ndeshem menjëherë në gjurmat që lë filozofia e jetës së përditshme dhe, duke u vënë këtyre si antitezë marksizmin, prapë nuk arrij të shpëtoj nga mendimet kontradiktore!..

— Dhe kurrë nuk do të shpëtosh nga ato, Izidor në qoftë se nuk do ta kalisësh veten! — ndërhyri Bernari. — Marksizmi në kokën tënde nuk mund të rrojë vetëm, i shkëputur, i izoluar. Vëre atë përballë jetës dhe në jetë ai gjen vendin e tij!.. Apo jam gabim?..

Unë për vehte nuk futem në arësytive të kotta për gjëra të vogla, që po t'i flak tutje, s'e dëmtoj revolucionin dhe po t'i lë të zmadhohen, bëhen të rrezikshme. Me një fjalë: në çdo hap të jetës sime më udhëheq ideja e revolucionit!..

— Ti e detyron veten?

— Po, përderisa kjo i shërben qëllimit tim.

— Oh, kjo mvaret nga njeriu, nga karakteri i tij! — tha Izidori me një gjest pakënaqësie për veten.

— Karakteri i njeriut është si hekuri, që punon në zjarr!

— E kuptoj; dhe ç'më këshillon ti, Bernar?

— Duhet të veprosh! Pregatitjet teorike du-

het t'i shoqërosh me veprimtari praktike revolucionare. Ti i ke të gjitha mundësitë..

— Këtë po bëj tani...

— Me cilët? Vetëm me intelektualët, me studentët! Kjo nuk mjafton.

— Ashtu vërtet; kam disa vjet që merrem kryesisht me ata. Duhet të mendohem, të kërkoj fushë tjetër veprimtarie... me punëtorët, bie fjala?..

Gjatë bisedës unë shikoja vetëm Izidorin. Ndiqja me vëmendje çdo fjalë, çdo gjest të tij. Edhe kur ai dëgjonte të tjerët, prapë unë atë shikoja. Në mimikën e tij dalloja fare qartë si në pasqyrë gjestet e Albanëzitet dhe të Bernarit. Në një rast, padashur, ktheva kokën nga Luiza, e cila ja kishin ngulur sytë Izidorit. Në vështrimin e saj shprehej simpatia, një simpati e madhe, që më bëri të dridhem për një çast nga xhelozia. Luiza sikur e kuptoi mendimin tim dhe më buzëqeshi me mirësi. Unë i nënqesha mekanikisht dhe ktheva kokën nga Albanezi, i cili i tha Izidorit:

— Nesër punëtorët e gazit dhe të elektrikut do të shpallin grevë, mbase e ke marrë vesht.

— Po... Mund të ketë ndonjë detyrë konkrete për mua?

— Këtu do të dilja... Për të përkrahur punëtorët, në rast nevojë, duhet të mobilizojmë edhe studentët!

— Mirë, por është pak vonë. Duhet të më kishit thënë më parë, shoku Moris!... Prisni!... Prapë mund të bëjmë diçka! Ta provoj një herë... — Izidori u mendua për një hop dhe u ngrit — Ku është telefoni? Hë, mirë, po i telefonoj Zhan Polit... është ai shoku, që na çoi me veturën e tij të Zherari, Zhaklinë! ..

Izidorit i shkrepën në kokë njëmijë mendime dhe përfytyrime (këto m'i shpjegoi të nesërmen, aty nga mbrëmja, kur e përcolla për në spital). Më i bukuri përfytyrim, që e gëzonte, që ja gufante zemrën nga entuziazmi, ishte ai i një revolucionari sypatrembur, hero, që s'kursen asgjë, as jetën, për çështjen e madhe të klasës punëtore. Instinktvet artistike iu ngjallën papritur. Izidori i shikonte gjërat nëpërmjet lentës së pasioneve, e cila ja trubullonte pak refleksin e sendeve dhe i jepte shkas fantazisë së tij t'i vishte ngjarjet me ngjyrrat e dëshiruara. Aty për aty përfytyrimi i kalonte nga njëra fazë në tjetrën: një herë i bëhej sikur fliste me zjarr para një sheshi të madh të mbushur me punëtorë të armatosur; herës tjetër sikur sulmonte një pallat madhështor, ku ishin strukur qeveritarët borgjezë... Këto ishin përfytyrime të një revolucionari klasik si ai i tetorit në Rusi...

Izidori qëndroi një copë herë i hutuar me dorëzën e telefonit në dorë.. Unë i thirra. Zëri im e shkëputi nga ëndërrimet, e solli në jetën reale. Ai u kthye nga ne, buzëqeshi dhe shkoi para Albanëzëve, duke marrë instinktivisht qëndrim gatitu dhe i raportoi se për gjysmë ore Zhan Poli do të ishte aty bashkë me veturën. Kështu, ata mund të fillonin menjëherë nga veprimtaria konkrete për të mobilizuar studentët në përkrahje të grevës së punëtorëve të gazit e të elektrikut.

Tamam pas gjysmë ore Zhan Poli ndali veturën para shtëpisë sonë. Ne zbritëm menjëherë, shkuam të katër bashkë: unë, Izidori, Albanëzi dhe Bernari. Luiza ndënji aty me punë të tjera.

Atë natë u kthyem vonë në shtëpi, pas orës tre të mëngjezit. Izidori nuk shkoi në spital; fjeti tek ne, në dhomën ku flinte më parë Zherari. .. Izidori e mbajti dritën ndezur për një kohë të gjatë. S'e zinte gjumi; mendonte... Të kaluarën e kujtonte gjithmonë me mall. Thoshte me vete: «Përse çdo gjë e shkUAR të mbush shpirtin me mallëngjim?... Ndofta nga që ajo iku dhe s'përsëritet më?!.. Mundet, por s'mjafton me kaq!.. Kujtimet e hidhura i sjell ndër mend me një farë nostalgjie, që më pezmaton!.. Kujtimet e bukura më mbushin zemrën me nostalgji optimiste dhe më bëjnë të shikoj larg në të ardhmen. Ndryshe po më ndodh tani: kujtimi i kësaj nate të mrekullueshme nuk më ngjall asnjë fije nostalgjie, vetëm sikur më shtyn të shikoj më mirë të sotmen, gjendjen time aktuale, më shtyn të kontrolloj veten me rreptësi, në jam i gatshëm për revolucion!». Këtu Izidori e ndërpreu mendimin: ideja e revolucionit shpërtheu me një shkëlqim të madh sa që ja verboi sytë e mendjes, e hutoi. Shuajti dritën dhe në errësirë filloi t'i shohiste punët me mendje të qetë... Kujtimet e asaj nate i dhanë një mësim praktik, e shtyn drejt veprimtarisë aktive. Para tij u hap një horizont i ri. Izidori kish bërë vetëm hapin e parë drejt tij.

Izidori ndiqte me vëmendje të thellë çdo ngjarje që paraqiste interes. Kjo gjë i ishte bërë zakon prej kohësh. Si jetonte një ngjarje, ai e përsëriste me mendje, e shohiste dhe ajo ngulitej mirë në kokën e tij. Ndofta më tepër në sajë të këtij zakoni se sa nga kujtesa e fortë ai ruante të freskëta shumë kujtime nga e kaluara e largët.

Por atë natë Izidori nuk arrinte dot t'i radhis-

te ngjarjet që të mundej pastaj t'i përsëriste me saktësi. Ideja se do t'u shërbente shokëve të vërtetë, se do t'i shërbente një qëllimi të madh, e kish entuziazmuar jashtë masës, prandaj gjithë vepërimet i kish kryer në një mënyrë mekanike sikur të shikonte një ëndërr të bukur.

Me këto mendime e zuri gjumi.

VRASJA E IZIDORIT

Disa dit pas grevës së punëtorëve të gazit dhe të elektrikut u zhvillua një manifestim i madh dhe i përgjakshëm në përkrahje të luftës çlirimtare të popullit algjerian. Në këtë manifestim u vranë tetë veta. Ndërmjet të rënëve ishte dhe Izidor Romeolja.

Unë mora pjesë në manifestimin e përgjakshëm, por s'u ndodha pranë Izidorit. Nganjëherë thoshja: më mirë që s'isha aty në ato çaste tragjike. Do të kishte qenë e tmerrshme për mua të shihja Izidorin pa jetë!.. Pas kësaj thoshja: më mirë të kisha qenë pranë Izidorit, krah për krah me të, të kisha rënë bashkë me të!..

Vrasja e Izidorit më hidhëroi pa masë. Unë u hutova, u bëra si njeri i kotë. Në këtë gjendje do ta kisha kaluar më lehtë hidhërimin. Por ironia e jetës doli edhe një herë kundër dëshirave të mia.. U vendos (pothuajse të gjithë partitë politike, organizatat dhe sindikatat e ndryshme ishin të një mendjeje) që të rënë të përcilleshin në vorreza me ceremoni të madhe funebre. Me kaq çdo gjë po rridhte në shtratin e zakonshëm. Por kur

u hapën fjalët që, ndërmjet kurorave të partive politike, do të kishte dhe kurora të qeverisë, e cila vuri xhandarët të hapnin zjarr kundër manifestonjësve, dhe shkaktoi tetë viktimat, unë s'munda ta përmbaja veten. Ky ishte kulmi i ironisë, prandaj më revoltoi! Kësaj i thoshin: ta vrasësh tjetrin natën dhe ta qash ditën!..

Në mëngjez herët filluan përgatitjet e fundit për ceremoninë funebre. Albanezi dhe Luiza u bashkuan me kortezhin e madh. Unë nuk shkova me ta, ngela vetëm në shtëpi. Albanezi më tha disa herë të shkoja për ta përcjellë Izidorin në banesën e fundit, ndërsa unë përgjigjesha me lot në sy: «Kjo është e tmerrshme, oh çfarë ironie!» — dhe më dridhej trupi nga dënesa. Albanezi nuk përpiqej të më shpjegonte se për ç'arësye duhej të shkoja bashkë me të në ceremoninë e varrimit të shokëve, kur dihej që edhe qeveria do të dërgonte kurorat e saj. Ai më thoshte shkurt: «Zhaklinë, ne duhet të jemi atje!».

Prita me veshë të ngritur një copë herë të madhe pranë dritares derisa asgjë nuk pipëtinte më brenda në shtëpi, pastaj shkova drejt e te dhoma, ku kishte fjetur Izidori. Sapo vura këmbën në prak të dhomës, ndjeva ngashërimin që më pushtoi zemrën. U drejtova nga shtrati. Ndërsa e shtrirë dhe pa lëvizur për një kohë të gjatë në shtratin ku kishte fjetur Izidori. U qetësova pak. Pastaj u ktheva përmbys dhe po nuhatja jastëkun. Më bëhej sikur ndjeja erën e Izidorit, që kish ngelur mbi jastëk si një aromë e njohur dhe e adhureshme, e cila më ngacmonte nervat. Pak

nga pak po i vija në udhë mendimet që më shqetësonin.

U çova nga shtrati, shkova në dritare. Hodha shikimin nga qielli. Kërkoja të gjeja diçka që të më ngushëllonte në natyrën indiferente. U kujtova shpejt. Izidorin s'e lidhte asgjë me natyrën; ose, më mirë: kujtimet nga koha që kalova bashkë me të s'kishin asnjë lidhje me natyrën... Në këto çaste ndjeva që dikush ecte nëpër sallon. U ktheva. Te dera u dha Luiza, e druajtur dhe e dëshpëruar. Sikur ngurronte të afrohej. Unë i buzëqesha. Ajo mori zemër dhe hyri brenda.

Luiza erdhi në një kohë shumë të përshtatshme. Siç dukej, ajo u kthye qëllimisht në shtëpi që të mos më linte vetëm. Ose i kish thënë Albanezi të kthehej. Iu luta Luizës të ulej në një karrige pranë tavolinës, që ndodhej karshi shtratit. Ajo u ul. Ndërsa unë qëndrova te dritarja dhe, pa e pyetur përse kishte ardhur, i thashë:

— Ti e njohe Izidorin, Luiza?

— Pak...

— Izidori ishte i fortë nga fjalët, nga mendimet, nga qëllimet. Për mua mjaftonte që ai të hapte gojën dhe bindesha se kishte të drejtë, e besoja menjëherë!..

— Sepse e dashuroje!

— Mbase, por kjo s'do të thotë se ai s'ishte i tillë!

— Si e ke njohur ti, Zhaklinë?

— Unë njoha disa anë të tij; nuk munda ta njihja deri në fund; s'pata kohë... Eh, Izidori! Nga t'ja filloj?...

— Nga të duash...

— Prit, Luiza!.. Kam ruajtur një blok me shënime të Izidorit. Kur isha në spital, pasi u njohta me Izidorin, më qëllonte nganjëherë që tërë ditën të gëzohesha, kurse gjithë natën të mendohesha. Ditën i gëzohesha atij, natën mendoja ato që kish thënë ai!.. Po shkoj të kërkoj blokun.

Shkova në dhomën time. Kërkova një copë herë në komodinën e vogël pranë shtratit dhe së fundi u ktheva te Luiza me blokun në dorë. U ula në një karrigë afër saj.

— Dëgjo! — i thashë duke shfletuar blokun. — Po të lexoj vetëm disa shënime të shkëputura, pa i analizuar. Duke lexuar mendimet e Izidorit, më duket sikur dëgjoj zërin e tij... Ja ç'shkruan këtu:

«Qëkurse njoha dhe fillova bashkëpunimin me Albanëzin, Bernarin e shokët e tyre, me këta revolucionarë ose, siç i quan Zhan-Poli, marksist-leninistë të vërtetë, jeta ime hyri në një rrugë të re, në atë që e kërkoja së koti në guaskën time intelektuale apo në rrethin tim mikroborgjez... E ndjej që fitova përsëri besimin e humbur dhe kjo m'i përtërin forcat. Revolucioni nuk është shfaqje teatrale, as një aventurë e këndshme romantike. Militanti i vërtetë duhet ta kuptojë këtë dhe të përgatitet, të mos ketë iluzione!.. Në revolucion rolin kryesor nuk e lozin meritat e njërit ajo tjetrit. Kjo është e rëndësishme, duhet kuptuar drejt! Revolucioni është çështje vendosmërie dhe aftësie. Aty çdo militant ka vendin e vet dhe duhet të bëjë atë punë për të cilën është më i aftë, më i devotshëm. Mirëpo militanti nuk duhet të zgjedhë vendin e tij sipas dëshirave apo meri-

tave, por simbas nevojave dhe interesave të revolucionit. Në betejat revolucionare nuk ka vend pretendimi mikroborgjez për punë të lehtë, të përshatshme për akësh person apo punë të vështirë, të madhe ose të vogël. Fundi i fundit për interesat e revolucionit, puna më e dobishme nuk është ajo që bëhet me më shumë bujë e sakrifica, por ajo në të cilën militanti ka sukses më tepër...».

Më tutje:

«Shpeshherë i hedh nga një sy të kaluarës si me. Për ta bërë më të qartë atë, i vë përballë figurën e Albanëzitetit. Dalin dy figura të ndryshme militantësh. Jeta ime ka qenë jetë me shpërthime, ajo përgatitej me durim, në luftë të vazhdueshme, të përditshme dhe priste çastet më të përshtatshme për të shpërthyer me të gjitha forcat e saj. Tani e kuptoj që kjo jetë mbante ere aventurizmi ose i përngjante deri diku jetës së një revolucionari romantik.

Kurse me Albanëzitetin ndodh ndryshe; është shumë vështirë ta vlerësosh këtë menjëherë. I hedh një sy jetës së tij: qysh katërmbëdhjetë vjeç me aktivitet revolucionar dhe deri tani që u plak. Një jetë e gjatë që ka kaluar nëpër shumë dallgë e furtuna. Duhet të kujtosh këtë gjë për të kuptuar Albanëzitetin si militant komunist, si revolucionar konsekuent. Kjo më sjell nëpër mend një përkufizim që e kam lexuar diku: forcat që shfaqen në një veprimtari të gjatë, shumëvjeçare, janë më pak të dukshme, nuk bien menjëherë në sy, kur i shikon ato në një rast ose në dy-tre raste të veçanta. Duhet pasur durim, objektivitet të thellë, largpamje të qartë dhe mundësi që t'i njohësh

këto forca në veprimtarinë e gjatë militante, që të kuptosh madhësitinë e tyre...

Unë dëshiroj dhe po përpiqem që të kem si model në veprimtarinë time militante Albanëzin!...».

Ja dhe këtu:

«Lëvizja e studentëve karakterizohet, në pamjen e parë, nga lufta për reforma arësimore, për përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve dhe për problemin e sigurimit të punës pas mbarimit të studimeve. Pra, duket se kjo luftë ka karakter ekonomik. Aty-këtu, ndonjë parullë politike, duket sikur humbet në flakën e luftës ekonomike. Po unë jam i bindur se nuk është e largët dita, kur revolta e studentëve, që zien si një vullkan i heshtur, do të shpërthejë me forcë të madhe dhe do të trondisë nga themelet sistemin kapitalist-imperialist. Në qoftë se lëvizja e studentëve do të jetë në gjendje të bashkërendisë luftën e saj me atë të klasës punëtore, fitoret do të jenë më të mëdha akoma.

Kështu mendon dhe Albanezi. Ai ka të drejtë!»

Këtu ndalova. E pyeta Luizën:

— Hë, Luiza, si të duket?

— Desha të thoshja diçka, Zhaklinë!

— Folë, folë, Luiza, po të dëgjoj!

— Unë e kuptoj që vrasja e Izidorit është një humbje e madhe për ty... si dhe për ne. Por unë shpresoj që ti nuk do të vajtosh për këtë humbje dhe as do ta harrosh shpejt atë!..

— Ç'të bëj tjetër për të larguar dhimbjen?

— Të ndjekësh rrugën e Izidorit!..

— Të bëhem komuniste?

— Po!

— Më duket e vështirë! Ti e di se nëpër ç'rrugë të tërthorta kaloi ai për t'u bërë komunist!

— Ti nuk je në kushtet e Izidorit, ti s'ke për të kaluar nëpër shtigjet e tij dhe unë nuk them që ta imitosh. Ti ke rrugën tënde origjinale, në radhë të parë ti je bijë punëtori, je rritur në një familje revolucionari. Unë them që të bëhesh komuniste për të vazhduar veprën e Izidorit. Sa për rrugën e Izidorit, unë mund të them se vetëm tri-katër herë e dëgjova e bisedova me të dhe e kuptova se fliste me zemër në dorë.

— Ai ashtu fliste gjithnjë, me cilindo! — e ndërpreva.

— Po, Izidori ishte i singërtë... Thashë, pra, se kuptova ato gjëra që duhej të kuptoja.

— Çfarë? — e pyeta me kërshtëri dhe u ktheva për ta shikuar në sy.

— Izidori m'u duk njeri me karakter të fortë. Ja se si më ka ngelur në kokë figura e tij si artist e militant... Izidori nuk ishte egoist, nuk luftonte për lumtërinë personale. Lumtëria për të ishte një ndjenjë e ulët, meskine. Ai e kuptonte se, po të arrinte lumtërinë — këtë gjë mund ta bënte duke vënë në shërbim të borgjezisë artin e tij — do t'i jepte fund jetës aktive si njeri i artit dhe si militant. Kjo do të ishte vdekje e ngadalshme për të, ai do të kthehej në një mekanizëm. Ai ishte njeri me talent të madh si artist. Për këtë kam dëgjuar të më flasin edhe të tjerë. Si i tillë, ai ishte tepër krenar, nuk pranonte të dilte fitimtar mbi kundërshtarë të dobët, donte të kishte të bënte gjithmonë me kundërshtarë të fortë... Pra,

kryesorja për Izidorin ishte madhështia, të ishte njeri me ndjenja dhe mendime të mëdha, i denjë për hove fisnike. Izidori me zotësinë e tij krijonte në jetë skena ose merrte pjesë, pa kursyer asgjë, në ngjarje që i shërbenin idealit të tij dhe sidomos në ato ngjarje, për të cilat mund t'i thoshte vetes pa druajtje: «Kësaj i thonë jetë me dinjitet!»... Këto fjalë s'ja thoshte askujt tjetër. Besoj as ty, Zhaklinë, nuk t'i ka thënë. Heronj si Izidori nuk i kanë qejf lajkat, siç ndodh me heronjtë që dalin nga gjiri i borgjezisë, bie fjala si me Pol Tenienin. Shpërblim më i madh për Izidorin ishte gëzimi që i falte jeta e gjallë, militante, në shërbim të një çështjeje të madhe..

— Këtu i ke rënë mu në shenjë, Luiza!..

Unë u hutova nga gjithshka që po dëgjoja, nga ato që lexova në ditarin e Izidorit dhe nga ç'më tha Luiza. Për disa minuta nuk isha në gjendje të nxirrja një fjalë të vetme.

Luiza u ngrit, ndezi një cigare dhe ul në karrigën përballë meje.

Unë i fola:

— Ju keni të drejtë, gjithmonë keni pasur të drejtë! E kam fjalën për ty, Albanezin dhe shokët e tjerë. Porse me veprimin e sotëm nuk bashkohem me ju, nuk mund t'ju kuptoj... Si arritët derisa të pranoni që për krah kurorave të shokëve të vihen dhe kurorat e vrasësit të Izidorit?! Kjo është një tallje, një poshtërim!..

— Zhaklinë, ti nxitohesh, nuk arësyeton! Ne s'ishim dakord për këtë gjë, në asnjë mënyrë. Por si mund ta ndalonim gjestin hipokrit të qeverisë?.. Lajmi na erdhi vonë. S'kishim ç'të bënim; ti e di

që ne nuk i kemi duart të gjata, s'kemi forca të mjaftueshme për të përmbysur planet e kundërshtarëve. Atëhere ç'të bënim? Vendosëm të shkonim bashkë me masën dhe para varreve të shokëve t'i tregonim asaj se kush ishin vrasësit e vërtetë, të demaskonim hipokrizinë e qeverisë, e cila bëri zhurmë të madhe në shtyp, në radio dhe televizion se gjoja i erdhi keq për gjakun që u derdh. Ky ishte rast i mirë gjithashtu për të demaskuar para syve të masës kompromisin e revizionistëve me qeverinë. Tjetër rrugë nuk kishim, a më kupton, Zhaklinë?..

— Jo, unë këtë s'e kuptoj! — thashë. Qëndrova një copë herë pa folur, duke ndjekur me një shikim të humbur lëvizjet në rrugë. Në këtë kohë para shtëpisë sonë u ndal një veturë, nga e cila doli një njeri me jakën e palltos ngritur, me cigare në gojë dhe me një republikë në ngjyrë hiri të errët ngjeshur mbi ballë. Ai u ndal para portës dhe po vështronte përpjetë nga dritaret e shtëpisë. I thirra Luizës. Ajo erdhi menjëherë pranë meje.

— Shiko; më duket se është Poli.

— Po, ai është — u përgjegj Luiza.

— Ç'kërkon tani?.. Ja, po i bie ziles... Mos e hap, Luiza!.. Jo, jo, shko hape!..

— Si? Përse?!

— Shko, shko, ai kot s'ka ardhur!

Luiza zbriti të hapte portën. Unë dola në sallon dhe po prisja e qetë. Pas pak hyri Luiza; pas saj Poli. Ai më përshëndeti dhe u ul në një karrigë pranë tavolinës në mes të sallonit. Mbështeti bërrylet mbi tavolinë dhe rrezoi kokën në pëllëmbë të duarve. Dukej i lodhur. Unë e pyeta Lui-

zën me vështrim. Ajo ngriti supet dhe më bëri shenjë të uleshim. Poli ngriti dy-tre herë kokën, duke buzëqeshur me vete. Luiza më bëri shenjë se ai kishte pirë. Më erdhi keq për të; i fola dhe i afrova paqetën me cigare. Mori një dhe kërkoi të pinte diçka. Luiza shkoi menjëherë në kuzhinë dhe i pruri një gotë me uiski. Poli e hodhi me një të ngritur dhe na vështoi të dyjave me buzën në gaz, me një buzëqeshje idiote. Pastaj tha:

— Ju s'paskeni shkuar në ceremoninë e varrimit të shokëve që u vranë?! As ti, Zhaklinë?!

— Po ti pse s'ke shkuar?

— Unë s'kam përse të shkoj në varrimin e të tjerëve, se ata s'kanë për të ardhur në varrimin tim!... Unë dua që asnjë të mos vijë në varrimin tim! Unë s'isha gjë dhe s'jam gjë. Tani e kuptova... E kush mund të vijë në varrimin tim?... Prindërit, që i mohova?!.. Apo shokët e partisë, që më deziluzionuan?... Edhe ata i mohova. Edhe ti, Zhaklinë, më mohove!.. Unë s'kam njeri, jam fill i vetëm në këtë botë. Aq më bën për botën tani, aq më bën për shokët!.. Dikur unë kam dashur më shumë parimet se njerëzit! Pastaj desha njerëzit më shumë se parimet. Por asnjëherë nuk gjeta atë që kërkoja!.. Ja se ku kam arritur unë, Zhaklinë,

Poli rrëzoi përsëri kokën në pëllëmbë të duarve. Në këtë çast Luiza më bëri shenjë duke dashur të më thoshte se ai s'ishte në vete prandaj të mos ja zgjatja muhabetin. Unë nuk iu binda. Nuk kuptoja përse fliste Poli ashtu, nga që ishte i dehur apo nga dëshpërimi. E pyeta:

— Pse erdhe këtu, Pol?

— Kot!.. A, prit!.. Që të të thoshja ty, Zhak-

linë, se unë u largova nga Zherari, nga partia. Mos më kërko më atje, po të kesh ndonjë nevojë! U largova nga partia i deziluzionuar!..

— Përse e bëre këtë, Pol? — e pyeta përsëri.

— Si pse?.. A, po, ti, s'di gjë! Ti s'di se ç'është politika! Ti s'di se ç'bëhet prapa skenës!.. Unë nuk mund të duroja më hipokrizinë. Parimet janë shumë larg nga veprat. Parimet u duhen udhëheqësve tanë për të mashtruar nshivët, që t'i mbajnë të lidhur pas qerres së tyre dhe jo më për të arritur objektivat, që janë caktuar me kohë... A e di ti se Antonelo Martini u përjashtua nga partia me urdhër të udhëheqjes pa përfillur fare mendimin e celulës së tij?.. Militantët e thjeshtë përdoren si gurë shahu. Xha Morisin e përjashtuan me urdhër të Zherarit. Edhe Izidori ishte vënë në shenjë... Por këto s'janë gjë!.. Veprimet e tyre për të bashkëpunuar, bie fjala, me socialistët, kompromiset që bëjnë, jeta e tyre private — sidomos kjo e fundit — s'kanë asgjë të përbashkët me komunistin, me idealin, që më pati shtyrë të hyja në parti... Një i njohur më tregoi një ditë një ngjarje kuptimplote. Është fjala për një avokat të dëgjuar, militant i Partisë Socialiste të Bashkuar. Ai kishte një apartament luksoz në lagjen 16. Në shtëpinë e tij u vendos të bëhej një mbledhje. Kur erdhën punëtorët aty — anëtarë të Partisë Socialiste të Bashkuar, — ngelën të hutuar nga luksi i apartamentit. Ç'propagandë konkrete mund të bënte avokati pas kësaj?! Kjo ngjarje më kujtoi prindërit e mi, pastaj udhëheqësit e Partisë Komuniste, që nuk rrojnë me keq se avoka-

ti socialist, bile më mirë se ai. Porse ata janë më të zgjuar se avokati, nuk bëjnë mbledhje të tilla nëpër vilat e tyre. Mirëpo unë i shikoja të gjitha. Nuk e di në i shihnin të tjerët. Aq më bën për të tjerët. Unë mohova prindërit e mi, mohova jetën luksoze, parazitare, që të luftoja për çështjen e klasës punëtore dhe rashë përsëri po në ato fole parazitare, me një ndryshim që këto të fundit ishin të maskuara nga jashtë me flamurin e kuq. U ruajta nga shiu dhe rashë në breshër!.. Kështu është... Mos t'ju vijë rëndë për Zherarin tuaj! Mos kini frikë për të. Unë e njoh mirë Zherarin: ai është më i riu në udhëheqjen e partisë, më aktiv dhe njeriu më i aftë, që di të shfrytëzojë çdo rast për të paraqitur veten dhe di të tërhiqet pa u ndjerë, pa rënë në sy, kur nuk duhet të duket... Mirë e ka: kudo ligjet e xhunglës ekzistojnë!.. Hej, djall-o punë!.. Luiza, sillëm dhe një gotë tjetër. Ta paguaj, kam para, vodha arkën e partisë. Pse them vodha?!. Mora atë që më takonte.. Apo jo? — dhe Poli qeshi si më parë, me një qeshje të dehuri që s'dallonte shumë nga qeshja e një idioti.

Luiza shkoi në kuzhinë pa bërë fjalë dhe pruri një gotë tjetër me uiski. Poli e ktheu gotën menjëherë, mblodhi buzët dhe u ngrit.

— Tani po largohem — tha.

— Ku do të shkosh? — e pyeta unë.

— Nga të më çojnë këmbët. Më falni për shqetësimin. Te dera e sallanit, para se të zbriste shkallët, ai u ndal:

— Zhaklinë, më erdhi keq për Izidorin; nuk e di përse! — tha Poli, pastaj filloi të zbriste shkallët duke u lëkundur.

Unë dola në dritare. E pashë Polin që hyri në veturë dhe e nisi me shpejtësi të çmendur. Prita atje sa u ngjit Luiza dhe i thashë se po shkoja në dhomën time të shtrihesha pak, derisa të vinte Albanezi. Desha të bisedoja me të po mbi ato gjëra për të cilat kisha folur me Luizën pak më parë, lidhur me Izidorin.

RRUGA E REVOLUCIONIT

Kaluan ditë, javë, bile dhe muaj. Unë s'po shkëputesha dot nga Izidori. E dashuroja akoma. Por kjo dashuri tani kishte një kuptim tjetër. Kur isha njohur me Izidorin, gjatë një kohe dashuria për të zinte vendin e parë në zemrën e mendjen time. Më vonë, dalëngadalë, kur idetë e Izidorit filluan të më tërhiqnin, sidomos kur shihja se si ato po ndryshonin e përparonin nën ndikimin e Albanëzitet, Bernarit e shokëve të tjerë, unë u kujtova për veten. Vura re se Izidori u afrua më tepër me mua pas takimit me Albanëzin. Kjo më dha të kuptojta se dashuria jonë mund të forcohej në luftën që do të bënim për kauzën e klasës punëtore... Pra, ndryshe nga Pol Tenieni, Izidori nuk më donte si një stoli, por si një shoqe lufte. Izidori nuk mund të dashuronte një vajzë — le të ishte kjo peri — me të cilën kur vinte puna për ojna dashurie, të ishte bashkë, ndërsa, në luftë për kauzën, ai të ndodhej në barikadë, kurse ajo ta priste në shtëpi duke u rregulluar para pasqyrës!.. Kështu dashuria jonë po merrte ngjyra më të theksuara, më të qarta.

Ndërsa tani, pas vdekjes së Izidorit, dashu-

ria për të, ose më mirë kujtimi i kësaj dashurie, kish marrë një forcë të veçantë, ishte një dashuri që kërkonte sakrifica, që kërkonte të vihej në vend amaneti i pashkruar për të vazhduar më me vendosmëri luftën për kauzën e madhe, për të cilën kish dhënë jetën Izidori.

Jeta gjithnjë e më tepër i jepte të drejtë Albanezit, ndërsa u çirrte maskën Zherarit dhe shokëve të tij. Vetë vrasja e Izidorit qe një pohim i fuqishëm i kësaj së vërtete.

Kështu kur horizonti m'u pastrua nga mjegulla, më doli e qartë perspektiva. Ahere unë e ndjeva veten të futur krejtësisht në rrugën e revolucionit, ndjeva tronditjet e hapave të para të marshimit në këtë rrugë të vështirë, që më nxisnin për herë e më tepër ta shpejtoja këtë marshim me qëllim që të arrija shokët që kishin dalë në ballë.

Në këto rrethana, me këto tronditje që po kaloja nuk munda të paraqitesha në provimet e sezonit të verës. E humba një vit, por nuk u dëshpërova; as Albanezi nuk u dëshpërua. Veçse ai ngulte këmbë që të filloja patjetër vitin e ri akademik. Unë nuk desha, nuk mundesha, nuk mund të filloja jetën studenteske menjëherë pas gjithë atyre që kisha kaluar. Albanezi më këshillonte duke më thënë se «detyra» e kërkonte që unë të ndodhesha në rrethin e studentëve. Së fundi iu binda këshillës së tij. Them këshillës dhe jo urdhërit të tij. Ai kurrë s'më urdhëronte. Për çudi, vura re diçka me këtë rast: kisha qejf që dikush të më urdhëronte! Kjo ndjenjë më bënte të nisesha menjëherë për të kryer «detyrën» me një fja-


lë të Albanezit apo të ndonjë shoku tjetër!..

Që në përpjekjet e para e pashë se kisha shumë boshllëqe nga ana e përgatitjes teorike. Fillova atëhere të studjoja veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, ato të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste Kineze. Mirëpo kjo dëshirë m'u kthye shpejt në një pasion: rrija me orë të tëra mbi librat, shpesh harroja të haja drekën ose darkën. Albanezi, që ndiqte me kujdes përparimin tim, më këshilloi që të mos isha e njëanshme, por të gërshetoja drejt përgatitjet teorike me veprimtarinë praktike. Unë bëra ashtu siç më tha ai dhe me ndihmën e tij po ja merrja dorën punëve që më ngarkoheshin.

Jeta e gjallë, gjithë aktivitet, që po më tërhiqte pa e kuptuar në gjirin e saj, filloi të më pëlqente, të më sillte kënaqësi. Në letret e jetës së re, uroja vazhdimisht që të më jepej rasti për të treguar se sa më vllente lëkura. Dhe rasti nuk vnoi të vinte. Në fillim të vitit të ri akademik, studentët bënë një grevë ndenjuri. Në të mora pjesë edhe unë (isha një nga organizatorët). U mbledhën të gjithë para Universitetit dhe u ulën në sheshe, në trotuare, në rrugë. Qarkullimi i automjeteve u ndërpre. Disa herë policia na paralajmëroi që të shpërndaheshim. Studentët nuk luajtën nga vendet që kishin zënë. Më së fundi policia përdori forcën... Tek unë erdhi një polic dhe më urdhëroi të ngrihesha. Unë e pashë shtrembër, e vendosur, duke buzëqeshur me ironi, pa luajtur nga vendi. Ahere polici më kapi nga krahu dhe më ngriti. Unë protestova. Ai s'ma vuri veshin, më shtrëngoi nga krahu dhe filloi të më tërhiqte. I

thashë të më lëshonte. Ai u ndal, më la të lirë dhe më urdhëroi të largohesha. Fjalët e tij ishin të rrepta, por në fytyrë dukej i qetë. Në këtë kohë policë të tjerë po ndërhynin dhe rreth nesh studentë dhe policë u bënë lëmsh. Unë u ktheva që të shkoja në vendin tim. Polici që ma kishte vënë syrin, më preu rrugën. Unë desha të shkëputesha nga ai; bëra një përpjekje të lehtë, mashtruese. I shpëtova nga duart, por ai menjëherë më hodhi dorën e majtë në gjoks. Ndjeva dhimbje dhe papritur i rashë policit me pëllëmbë në fytyrë. Atëhere ai më kapi nga flokët me një dorë dhe me tjetrën më shtyn-te nga pas. Nga dhimbja sytë m'u mbushën me lot. Megjithatë shtrëngoja dhëmbët që të mos e lëshoja veten. Zemrën ma pushtoi urrejtja për policin, që më kish mbërthyer si ndonjë bishë. Pastaj thashë me vete: «Ky është një vegël qorre, shërbëtor i borgjezisë. Urrejtjen personale për të le ta kthej në urrejtje klasore, kundër borgjezisë! Mos t'i harroj këto çaste!.. Duhet përmbysur borgjezia që të çlirohet njeriu!. Kështu mund të çlirohet edhe kjo vegël qorre, që po më torturon tani!». Ky arësyetim më bëri të qesh me vete: unë s'isha vetë e lirë dhe mendoja për lirinë e policit!.. Ai më nxori nga turma, hoqi dorën nga flokët e mi, më përdrodhi krahët nga prapa dhe më futi brenda në një kamion të mbuluar, që e përdornin për transportimin e të arrestuarve. Kamioni ishte mbushur plot me studentë. Pas meje u mbyll dera dhe kamioni u nis në një drejtim të panjohur.

Na çuan në një rajon policie. Na futën në një dhomë-burg. Atje kishte vetëm dy stola të gjatë,



në të cilët u ulën vajzat. Djemtë rrinin në këmbë. Ata bisedonin me zë të lartë. Të gjithë dukeshin optimistë, bënin shaka. Kështu qëndruam gati dy orë. Pastaj na thirrën një nga një. Në fillim dolën vajzat. Mua më lanë të fundit. Për këtë gjë shokët u shqetësuan. Dy nga ata s'deshën të dilnin para

meje. I detyruan të dilnin. Pastaj më thirrën mua. Që nga dhoma-burg deri në një zyrë më shoqëroi polici që e kisha qëlluar me pëllëmbë në fytyrë. Tani s'kisha më urrejtje për të, se nuk ndjeja asnjë dhimbje. Veçse solla ndër mend mënyrën se si më kapi nga flokët, prandaj e përbuzja. Ai s'meritonte më tepër se përbuzje, ishte një shërbëtor i thjeshtë. Urrejtjen duhej ta ruaja për padronin e tij. Në zyrë polici më tha të ulesha në një karrigë. U ulë. Ai më zgjati paqetën me cigare. Unë s'e pranova. Ai e vuri paqetën në xhep. Bëri dy-tri herë ecë e jakë para meje, duke më hedhur nga një vështrim. Edhe unë e shikoja. Ai dukej i qetë dhe i kënaqur nga një mendim i çuditshëm. Unë nuk e njihja psikologjinë e policit, prandaj u përgatita për ndonjë të papritur.

— Socialiste, radikale... në ç'parti bëni pjesë? — më pyeti.

— Komuniste! — iu përgjegja.

— Po dashnori... desha të thoshja i fejuari, komunist është?..

— Unë jam e ve! — thashë pa dashur.

— Ah, më falni; më vjen keq, kaq e re dhe e bukur!.. Ç'fatkeqësi!.. Burri juaj ishte komunist?

— Po!

— Ka vdekur në ndonjë aksident?

— E vranë xhandarët... .

— Ju jeni shumë e ashpër dhe e padrejtë! — tha ai dhe filloi përsëri ecë e jakë. Pas një çike u ndal para meje.

Unë e pyeta:

— Hetues jeni ju?

— Jo!
— Atëhere me ç'të drejtë më pyesni?!..
— Si njeri i fyer dhe si mik i Pol Tenienit,
të fejuarit tënd!

— Ishte!..
— Ti gënjen, Zhaklinë!

— Jo!
— Këtu në rajon të njoha. Ti paske fat!
— Ç'kërkon nga unë? — e pyeta pak e inato-
sur. Tani që më kujtoi Polin, unë fillova ta ndje-
ja që po më merrej fryma në atë zyrë.

Polici më tha:

— Të më kërkosh falje për gjestin e ulët që
bëre karshi meje! Unë me kaq po e mbyll...

— Nuk mundem.. Pastaj, ti e meritoje!

— Unë bëra detyrën..

— Edhe unë.

— A e di ti se ç'të pret, po të zgjatet muha-
beti?

— Jo.

— Burgu!

— Aq më mirë!

— Të është mërziur jeta — më pyeti ai me
një buzëqeshje tallëse.

— Përkundrazi!

— Ti qenke kokëfortë, e paarësyeshme! Pra-
pë unë s'po e bëj çështje, për shkak të Polit, ta
dish!.. — tha i mërziur.

— Për mua është njësoj!

— E kuptova; tani ngreu, shko përpara; ke
disa formalitete për të plotësuar, si të gjithë sho-
kët e tu.

Duke dalë përpara mikut të Pol Tenienit, në

atë çast se si më erdhi nëpër mend greva e famshme e policëve, të cilët ishin grumbulluar para parlamentit për të kërkuar ngritjen e rrogave. Thashë me vete: «Këta njerëz, për interesat e tyre u ngritën kundër padronit dhe sot i shërbyen me zell po atij padroni për të shtypur grevën tonë! Këta njerëz përbëjnë llumin e shoqërisë sonë, s'kanë dinjitet, u mungon ndjenja shoqërore ashtu si vagabondit!.. Nuk ja vlen të merrem me ta!»...

Pata fat që s'më mbajtën shumë në plotësimin e formaliteteve të detyrueshme. Kur dola nga rajoni, sikur mora frymë lirisht. Shokët po më prisnin jashtë. U bashkova me ta dhe u larguam menjëherë të gjithë grup. Sapo bëmë hapat e para, më kapi nga krahu Bernar Maiku dhe më tha se pak më tutje priste Albanezi. Ahere u kërkoja lejë shokëve studentë dhe shkova me Bernarin. Ata vazhduan rrugën, duke më përshëndetur herë pas here me dorë derisa u zhdukën pas një kthese... Albanezi më priste brenda në veturë. Unë hipa përpara, Bernari prapa me Albanëzin. Në timon u ul një djalë i ri. Vrava mendjen për disa çaste për ta njohur dhe m'u kujtua: ishte shoku i Izidorit, Zhan-Poli, ai që na kish çuar me veturë te Zherari. I buzëqesha, pastaj i dhashë dorën. U nisëm. Rrugës për në shtëpi, Bernari më ngacmonte që t'i flisja për aksionin tim të parë politik. Unë s'kisha qejf të flisja, më pëlqente të rrija në heshtje, të qetësoja nervat e acaruarat. Mirëpo Bernari ngulte këmbë dhe, më në fund, më bëri të flisja... Ua tregova me hollësi se si u përgatit greva e studentëve dhe se si më ndezi me policin, mikun e Pol

Tenienit. Bernari dhe Zhan-Poli qeshnin pas çdo skene, duke bërë komentet e rastit. Unë s'e kuptoja pse qeshnin: a skenat ishin të atilla që të bënë për të qeshur, apo unë i tregoja me marifet dhe u jepja ngjyra humoristike. Unë për vete nuk qeshja. Ktheja herë pas here kokën prapa. E shikoja që edhe Albanezi buzëqeshte i kënaqur. E dija që ai ishte i kënaqur nga unë, për aksionin tim të parë politik. Mendova: «Mbase është për të qeshur, unë nuk e kuptoj; nuk i kuptoj njerëzit, të cilët i çmoj, prandaj le të bëj edhe unë ashtu siç bëjnë ata!.. S'dihet, ndofta më del më mirë kështu, po të ve pak rregull, disiplinë në kokën time». Ky mendim s'kishte lidhje drejtpërdrejt me gazin e shokëve, sepse, në të vërtetë, unë kisha kohë që përpiqesha të vija rregull në mendimet e mia.

Pak nga pak, gazi optimist i shokëve po hyn-te në zemrën time të ftohtë si një ngroh-tësi e këndshme dhe e nevojshme. Më së fundi, ku u ndalëm para shtëpisë, edhe unë qesha pas aq muajve të kaluar me trishtim dhe, për çudinë time, qesha me gjithë zemër, jo e shtirë...

Tiranë, 1964-68.